



---

Lessons Learned and Analysis  
Unit of the EU Pillar of UNMIK in Kosovo

## **DILEMA OTOMANE**

**MARREDHENIET E PRONES DHE TE PUSHTETIT  
NEN MISIONIN E KOMBEVE TE BASHKUARA NE KOSOVE**

**8 gusht 2002  
Prishtinë**

**DILEMA OTOMANE: MARRËDHËNIET E PRONËS DHE TË PUSHTETIT  
NËN MISIONIN E KOMBEVE TË BASHKUARA NË KOSOVË**

NJËSIA E MËSIMEVE TË MËSUARA DHE ANALIZAVE<sup>1</sup>

~ përmbajtja ~

<b>I. HYRJE</b>	<b>5</b>
<b>II. KONTEKSTI</b>	<b>7</b>
<b>A. Deindustrializimi i Kosovës</b>	<b>7</b>
<b>B. Rënia e pronës shoqërore</b>	<b>9</b>
<b>III. UNMIK – KUJDESTAR I BESUESHEM I PRONËS SHOQËRORE</b>	<b>11</b>
<b>A. Kontrollat e ndërmarrjeve pasluftës</b>	<b>12</b>
<b>B. DTI-ja dhe ringjallja e demokracisë në vendet e punës</b>	<b>13</b>
<b>C. Fantazmat e socializmit vetëdrejtues</b>	<b>16</b>
<b>D. Koncesionet e NSH-ve</b>	<b>19</b>
<b>IV. DILEMA OTOMANE</b>	<b>24</b>
<b>V. DREJT KRIJIMIT TË PRONËS NË KOSOVË</b>	<b>26</b>
<b>A. Nënshtrimi i NSH-ve ndaj ligjit</b>	<b>28</b>
<b>B. Fundi i keqpërdorimit të pronës shoqërore:</b>	<b>30</b>
<b>C. Përgatitja për privatizimin në shkallë të vogël</b>	<b>31</b>
<b>D. Koalicioni për reformën e pronës</b>	<b>31</b>

---

<sup>1</sup> Njësia e Mësimeve të Mësuara dhe Analizave (LLA) është një projekt i Shtyllës së BE-së të UNMIK-ut dhe Iniciativës Evropiane për Stabilitet (ESI). Ajo ka për qëllim t'u sigurojë hartuesve të politikës dhe publikut në Kosovë një pamje të jashtme me një analizë të pavarur politike bazuar në kërkime empirike në terren. Mendimet e shprehura në raportet e saj janë ato të LLA -së dhe nuk përfaqësojnë ato të Shtyllës së Bashkimit Evropian dhe stafit të tij apo UNMIK-ut. Bordi këshillues i LLA-së përbëhet nga *Martti Ahtisaari, Peter Arbenz, Carl Bildt, Thomas Carothers, Alain Le Roy, Ian Martin, Gary Matthews* dhe *Alex Rondos*.

**DILEMA OTOMANE: MARRËDHËNIET E PRONËS DHE TË PUSHTETIT  
NËN MISIONIN E KOMBEVE TË BASHKUARA NË KOSOVË**

**PËRMBLEDHJE**

Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) ka marrë përgjegjësinë e kujdestarit dhe administruesit të një pjese të madhe të pronës shoqërore dhe asaj shtetërore në të gjithë Kosovën, duke përfshirë 370 ndërmarrje shoqërore (NSH). Megjithatë gjatë tre viteve të kaluara ka pasur mungesë të burimeve institucionale për të krijuar një regjim efektiv të pronës. Si rezultat i kësaj, kontrolli ndaj disa prej pasurive ekonomike më të vlefshme të Kosovës po përcaktohet jashtë sistemit ligjor, në përlëshje individuale të panumërta për pushtet në të gjithë Kosovën. Rezultatet kanë qenë të dëmshme si ndaj zhvillimit ekonomik, stabilitetit shoqëror dhe politik ashtu dhe krijimit të shtetit ligjor.

Ky raport analizon strategjitë e ndryshme të marra nga UNMIK-u për të përmbushur përgjegjësinë e tij si kujdestar i mirëbesuar i pronës shoqërore, duke përfshirë administrimin direkt të NSH-ve, restaurimin e demokracisë jugosllave në vendin e punës ('vetë-administrimin') sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet të vitit 1988 dhe dhënien e koncesioneve të NSH-ve tek investuesit privatë ('komercializimi'). Kështu arrihet në përfundimin që këto përpjekje kanë bërë shumë pak për ta ndalur konfuzionin tek prona komerciale apo për të promovuar një ambjent më të përçueshëm për rritjen e sektorit privat.

Kjo është 'dilema otomane' e UNMIK-ut: për shkak të kapacitetit të tij të kufizuar misioni ka ndërhyrë në administrimin e NSH-ve dhe pronës së tyre vetëm në rastet kur i janë paraqitur mosmarrëveshje të caktuara. Përpjekjet e misionit për ta mbajtur ritmin kanë çuar në pranimin e marrëdhënieve ekzistuese të pushtetit dhe zgjidhje të ndryshme dhe të lokalizuara të problemeve komplekse. Ashtu siç e gjetën reformatorët otomanë Ballkanin në shekullin 19, autoriteti formal ligjor ndaj pronës, megjithëse i fortë në letër, nuk është një influencë e çiltër e botës reale. Pa aparatit administrativ dhe rregullues të një shteti modern, UNMIK-u ka besuar në tolerancën e komisionerëve të pushtetit të pasluftës, duke rrezikuar parimin e zbatimit uniform të ligjeve.

Në qershor të vitit 2002 UNMIK-u themeloi Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) si shtëpinë e re institucionale për autoritetin e saj ndaj ndërmarrjeve shoqërore. Duke pasur parasysh eksperiencën e tre viteve të kaluara, AKM-ja ka të ngjarë të arrijë një numër të vogël privatizimesh të suksesshme dhe ndoshta pak likuidime. Ka rrezik që pjesa më e madhe e NSH-ve do të lihet të luftojë në gjendjen aktuale në të cilën ndodhen. Krijimi i një sistemi konsistent, të qëndrueshëm për të drejtat e pronës në Kosovë kërkon, përveç krijimit të AKM-së, një aleancë të gjerë dhe të ndërtuar mirë të institucioneve duke përfshirë të gjitha Shtyllat e UNMIK-ut, Autoritetin Qendror Fiskal (AQF), Ministrinë e Punës dhe Mirëqënies Sociale po ashtu edhe organet komunale, agjencitë kadastrale, organizata të tjera të cilat ofrojnë mbështetje teknike ndërkombëtare në këtë fushë.

Mësimet që duhet të nxirren nga kjo fushë shtrihen përtej çështjes së pronës shoqërore.

Së pari është relativisht e lehtë për një mision ndërkombëtar të shpallë autoritet ligjor në një fushë por është shumë më e vështirë për të ndërtuar burimet institucionale për përmbushjen e një përgjegjësie që ekziston në letër. Ka rreziqe të qarta në marrjen e kompetencave pa kapacitetin për t'i ushtruar ato. Fusha shoqërore nuk mbetet kot, në pritje të bashkësisë ndërkombëtare për të ndarë vëmendjen dhe burimet. Çdo boshllëk autoriteti është i mbushur

nga aktorët vendas. Në fushën e pronës shoqërore, UNMIK-u ka marrë autoritet administrativ ndaj të gjithë ekonomisë publike dhe më pas ia ka dorëzuar kontrollin një departamenti i cili në shtator të vitit 2001 kishte një personel prej vetëm 21 vetësh (11 të huaj dhe 10 kosovarë) në të gjithë Kosovën për t'u marrë me ndërmarrjet shoqërore. Rezultati ishte se ky institucion me burime të pakta mbeti i kufizuar ndaj luftrave të vërteta për kontrollin e pasurive në këtë fushë.

Së dyti KB-ja gaboi duke pretenduar se mundësia më e sigurtë do të ishte ruajtja e *status quo*, duke dhënë premtime boshe për 'ligjin e aplikueshëm' të vitit 1980. Kjo strategji la një pjesë të madhe të pasurive më të vlefshme të Kosovës në një vakum ligjor, brenda një sistemi të socializmit vetë-administruar, kontrollin institucionale të të cilit ishin disintegruar. *Statusi quo* ishte kryesisht i dobët, duke shpërndarë konfuzion në fushën e pronës komerciale e cila rrezikoi qëllimin kryesor të misionit të KB-së për krijimin e një ekonomie të vlefshme nën shtetin ligjor. Zëvendësimi i sistemit të vjetër me një regjim funksional të pronës ishte një pjesë e nevojshme e detyrimit ndaj kujdestarisë së KB-së dhe mosarritja e kësaj ka sjellë shpenzime domethënëse ekonomike dhe sociale. Thjesht është e pamundur të shtyhet dhënia e përgjigjeve të pyetjeve të vështira mbi pronën deri pas rezolutës mbi statusin përfundimtar të Kosovës.

Së treti asnjë ndryshim social i thjeshtë nuk mund të vijë pa identifikuar dhe punuar me zgjedhësit dhe interesat vendase me një rrezik në reforma të tilla. Për këtë arsye krijimi i pronës dhe zgjidhja e statusit të NSH-ve nuk është thjesht një konservë e ekonomistëve dhe avokatëve, por një problem ekonomik dhe social *par excellence*. Ky problem i shqetëson të gjitha Shtyllat e UNMIK-ut, donatorët ndërkombëtarë si dhe institucionet e reja të vetë-qeverisjes kosovare. Për të pasur sado pak shanc për sukses, kërkohet një përpjekje e përbashkët e të gjitha këtyre institucioneve. Ky raport sugjeron krijimin e dërgatës pronësore me bazë të gjerë, e cila do të mobilizonte përpjekjet e një koalicioni më të gjerë institucionesh sesa është parë deri tani.

UNMIK-u ka arritur në një pikë kritike të administrimit të tij në Kosovë. Me pakësimin e donacioneve ndërkombëtare vitin e ardhshëm dhe me vrullin e ndërtimeve të pasluftës dhe me ngadalësimin e lulëzimit të strehimit, për t'u zhvilluar më tej, sektori privat i Kosovës ka nevojë urgjente për një regjim funksional pronësor.

Ky raport jep një informacion të detajuar mbi shfaqjen e institucioneve destruktive shoqërore në fushën e pronës shoqërore. Kjo siguron gjithashtu një paketë me rekomandime të caktuara se si UNMIK-u mund t'i zëvendësojë ato përmes një strategjie me bazë të gjerë për krijimin e pronës, duke pasur parasysh burimet ekzistuese administrative dhe financiare:

- a) NSH-të t'i nënshtrohen ligjeve të njëjta si ndërmarrje private, veçanërisht në fushat e taksave dhe marrëdhënieve të punësimit. T'i kërkojë atyre të paguajnë faturat e shërbimeve publike, si një element kyç drejt forcimit të kufizimeve të buxhetit. Përdorimi i këtyre mekanizmave ligjore si për fillimin e procesit të mbledhjes sistematike të informacionit për NSH-të dhe për të përcaktuar se cilat NSH kanë biznes aktiv dhe në cilat prej tyre duhet të procedohet menjëherë me likuidim.

- b) Të zbatohen rregullat në ligjet e aplikueshme kundër dhënies me qera të pronës shoqërore nga NSH të ndryshme. Reduktimi i synimit të drejtuesve të NSH-ve për të vjelur të ardhura në para të pa merituar do të ndihmonte në shuarjen e konflikteve në lidhje me kontrollin e NSH-ve dhe do të kufizonte rezistencën ndaj privatizimit apo likuidimit eventual.
- c) Të fillohet procesi i privatizimit në shkallë të vogël për pasuritë individuale shoqërore.

“Ekonomia po rifillon me një shpejtësi të pabesueshme ... Jashtë nëpër rrugë shihen tregje plot jetë, shihen blerje dhe shitje dhe kjo është blerje-shitje jo vetëm e sendeve ushqimore por edhe e materialeve të ndërtimit e kështu me rradhë. Kështu në Kosovë ekonomia është në këmbë dhe duke vrapuar dhe nëse duam që kjo ekonomi të jetë një ekonomi tregu normale, ne gjithashtu duhet të jemi në këmbë dhe duke vrapuar sepse rregullat e tregut duhet të vihen në vend. Tregu është aty ndërsa rregullat nuk janë.”

*Joly Dixon, Shefi i Shtyllës së BE-së,  
Kosovë, 28 korrik 1999<sup>2</sup>*

“Krijimi i pronës nuk është fare si një program privatizimi i cili përfshin vetëm shitjen e një dyzine pasurish çdo vit. Synimi i reformës së pronës është dhënia e të drejtave të pronës për miliona asete tek miliona njerëz në një kohë të shkurtër. Kjo do të thotë që të paktën gjysma e punës ka të bëjë me komunikimin ... Udhëheqësit e reformës së pronës duhet të përshkruajnë se si kapitalizmi popullor do të ndikojë në shumë grupe të ndryshme interesash, t’u tregojë atyre të mirat që do të vijnë nga ajo dhe t’ua mbushë mendjen atyre se është një ushtrim fitimprurës për të gjitha elementet e shoqërisë.”

Hernando de Soto, 2000<sup>3</sup>

## **I. HYRJE**

Kur Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovoë (UNMIK-u) themeloi administratën e tij të përkohshme në verën e vitit 1999, e emëroi veten administrator të të gjithë pronës së shtetit. Gjatë vitit të parë të misionit të tij, e zgjeroi këtë autoritet mbi frytet e pesë dekadave të industrializimit socialist në Kosovë: rreth 370 ndërmarrje shoqërore (NSH).<sup>4</sup> Me konfuzionin ligjor që e rrethon statusin e Kosovës dhe një dekadë reformash të pjesshme nën Milosheviçin, askush nuk ishte i sigurtë se si duhet të karakterizoheshin këto NSH. Por këndvështrimi i UNMIK-ut ishte mjaft pragmatik: “rezultatet e prodhimit të një ndërmarrjeje shoqërore i takojnë shoqërisë si e tërë, p.sh. publikut”.<sup>5</sup>

<sup>2</sup> Fjalim nga Joly Dixon, konferenca e parë e donatorëve për Kosovën, Bruksel, 28 korrik 1999.

<sup>3</sup> Hernando de Soto, *Misteri i Kapitalit*, 2000, fq. 206.

<sup>4</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 1999/1, sipas Rregulloreve 1999/24 dhe 2000/59. Baza e të dhënave më e fundit për NSH-të e mbajtur nga UNMIK-u rradhit 339 NSH në qershor 2002. Megjithatë është pothuajse e sigurt që ka më shumë NSH se ky numër. Duke shtuar të dhëna nga zyrat rajonale numri arrin deri në 370 dhe ndoshta ka të tjera që nuk janë identifikuar akoma. Plus kësaj AKM-ja do të jetë gjithashtu përgjegjëse për të gjithë pronën shoqërore në sektorin bujqësor.

<sup>5</sup> UNMIK-u, *Dorë e lirë në Zhvillimin e Ndërmarrjeve*, 7 shtator 2000 (e përgatitur bashkarisht nga KB-ja dhe Shtylla e BE-së).

Kështu me një të lëvizur të dorës UNMIK-u e emëroi veten kujdestar dhe pronar të pasurive të patundshme më të çmuara të Kosovës. Kjo përfshin ndryshimin e gabuar të pasurive të cilat përbëjnë ekonominë publike të Kosovës, nga mijëra dyqane qoshesh në çdo qytet dhe provincë deri në kompleksin zvarritës të Trepçës në Mitrovicë. Me themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) në qershor të vitit 2002, ky autoritet gjeti një shtëpi të re institucionale.<sup>6</sup>

Megjithatë kujdestaria jep si përgjegjësi ashtu edhe autoritet – në këtë rast përgjegjësi për të zotëruar autoritetin e saj për të mirën më të madhe të ekonomisë dhe shoqërisë së Kosovës. Në realitet kapaciteti i UNMIK-ut për të luajtur rolin e shtetit dhe administruar pronën publike ka qenë sigurisht i parëndësishëm. Burimet që zotëronte Departamenti i Tregtisë dhe Industrisë kanë qenë modeste dhe në praktikë UNMIK-u ka pasur shumë pak influencë në lidhje me atë se çfarë ndodh brenda këtyre ndërmarrjeve. Ka qenë e pamundur të hartohet një listë e saktë e NSH-ve, punonjësve të tyre, pasurive ose aktiviteteve. Pyetjet më themelore – kush i kontrollon pasuritë, kush përfiton nga të ardhurat që sjellin ato – zgjidhen jashtë sistemit ligjor, përmes luftrash individuale të panumërta për pushtet në të gjithë Kosovën.

Rezultati është se Kosova sot ka një sistem prone dual: një treg të hapur shpesh mjaft konkurent ku kompanitë private ofrojnë pronë komerciale të pamjaftueshme dhe konkurojnë për klientë si dhe seri pasurish të patundshme pothuajse feudale, ku një pakicë e privilegjuar zotëron kontroll ndaj pasurive që i takojnë ‘shoqërisë si e tërë’ dhe i kthejnë të ardhurat në të mira të tyre personale. Ky sistem dual është edhe mjaft i paefektshëm dhe thellësisht i padrejtë. Kompanitë private qëndrojnë ose bien në aftësinë e tyre për të kthyer një profit; NSH-të mbijetojnë përmes aftësisë së tyre për të shfrytëzuar dobësinë e administratës së UNMIK-ut. Kompanitë private paguajnë qera të tepruara për pasuritë e patundshme; NSH-të i subvencionojnë bizneset e vjetëruara duke i dhënë ato me qera. Bizneset private mbajnë barrën më të madhe të taksave; drejtuesit e NSH-ve dhe grupet e vogla të punëtorëve ndajnë ndërmjet tyre të ardhura nga qera të pa taksuara. Sektori i ri privat paguan për të plotësuar infrastrukturën dhe shërbimet publike inadeguata; NSH-të i përdorin shërbimet por paguajnë shumë rrallë për to. Nëse prosperiteti ekonomik dhe krijimi i vendeve të punës janë kritike për të ardhmen e Kosovës atëherë prioriteti për misionin ndërkombëtar është prishja e këtyre patundshmërive pothuajse feudale dhe zëvendësimi i tyre me një sistem të drejtë dhe efektiv për të drejtat e pronës.

Ky raport është i bazuar në muaj hulumtimesh në terren nga ana e Njësies së Mësimeve të Mësuara dhe Analizës së Shtyllës së BE-së në rrënojat e sektorit shoqëror. Ky ekzaminon strategjitë e ndryshme të zgjedhura nga UNMIK-u gjatë tre viteve të kaluara në përmbushjen e mandatit të tij si kujdestar i pronës shoqërore. Analizon gjithashtu marrëdhëniet e pronës ashtu siç janë në terren si dhe shpenzimet ekonomike dhe sociale të konfuzionit aktual. Bën gjithashtu disa propozime konkrete për politikën e ardhshme ekonomike në këtë sektor. Pyetja qendrore së cilës kërkon t’i japë përgjigje është se çfarë sistemi taksash mund të sjellë UNMIK-u për të kaluar një *status quo* të pambrojtur, duke pasur parasysh kufizimet aktuale ligjore, financiare dhe të burimeve njerëzore.

Raporti arrin në përfundimin që strategjia më efektive do të ishte marrja e sistemit taksativ modern të zhvilluar nga Autoriteti Qendror Fiskal i UNMIK-ut gjatë tre viteve të fundit dhe zbatimi i tij në të njëjtën mënyrë në sektorin shoqëror. Ekziston një lidhje direkte mes taksimit dhe një sistemi modern të të drejtave mbi pronën. Një sistem taksor efektiv nuk

<sup>6</sup> Shiko Rregulloren 2002/12 mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, 13 qershor 2002.

mund të funksionojë pa të drejta të qarta pronësore dhe historikisht nevoja e shtetit modern për të siguruar të ardhura është ajo që ka çuar në zhvillimin e sistemit pronësor.

Zgjerimi i sistemit të taksimit dhe ligjeve të tjera të aplikueshme në Kosovë në sektorin e NSH-ve do të çojë përpara zhvillimin e shumë qëllimeve të rëndësishme. Kjo do të vështirësonte kufizimet buxhetore mbi NSH-të duke ndihmuar në seleksionimin e kandidatëve më premtues nga ata jo premtues për privatizim. Kjo do të lehtësonte shumë punën e Agjencisë së re Kosovare të Mirëbesimit, duke e lejuar atë t'i përqendrojë burimet e veta në numrin e kufizuar të NSH-ve të cilat janë vërtet premtuese. Përsa i përket atyre NSH-ve pa të ardhme por akoma në funksionim, do të ishte e udhës të përcaktoheshin pasuritë e tyre produktive dhe vënia e tyre në qarkullim në tregun e hapur. Gjithashtu kjo do të ndihmonte në zhvillimin e një sistemi të paanshëm dhe të qëndrueshëm të ardhurash i cili është thelbësor për sa i përket kapacitetit të Kosovës për vetëqeverisje efektive.

E parë në aspektin kritik kjo njëkohësisht është një strategji në të cilën UNMIK-u do të kishte disa aleatë të natyrshëm. Sektori i ri privat dinamik i Kosovës dhe institucionet e tij të reja të vetëqeverisjes kanë një interes të përbashkët në përfundimin e statusit efektiv pa taksa të pronës shoqërore. As sektori privat dhe as donatorët ndërkombëtarë nuk kanë interes në vazhdimin e subvencionimit të relikeve të industrive socialiste. Ndërkohë që asistencë e huaj fillon të bjerë dhe masa e të ardhurave të mbledhura në kufinj është në rënie, insitucioneve të Kosovës do t'u nevojiten burime të reja të ardhurash që nuk e rrisin peshën e taksave në sektorin privat. Duke marrë parasysh vështirësitë në të cilat është përballur UNMIK-u në përpjekjet për të imponuar vullnetin e tij mbi NSH-të gjatë tre viteve të fundit, mobilizimi i një mbështetjeje më të gjerë duhet të jetë një përbërës kritik i strategjisë.

Krijimi i një sistemi konsistent për të drejtat e pronës në Kosovë do të kërkojë një aleancë të gjerë dhe të strukturuar mirë të insitucioneve, duke përfshirë Autoritetin Qendror Fiskal (AQF), Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqënies Sociale. Do të duhet të bëhet një rishqyrtim i prioriteteve ndërkombëtare në shpërndarjen e burimeve për asistencë teknike dhe ndërtim të insitucioneve nga UNMIK-u si dhe nga donatorët ndërkombëtarë kryesorë. Ç'ka është më e rëndësishme, duhet të bëhet një fushatë politike e sofistikuar për të bindur segmentet e gjera të shoqërisë kosovare për të mirat e një politike të tillë dhe rolin e saj në krijimin e një fushëveprimi me vinele të ndryshme për zhvillimin ekonomik. Mësimi kryesor i nxjerrë nga tre vitet e fundit është se një fushatë e tillë është thelbësore nëse politika dhe strategjitë e zhvilluara nga UNMIK-u ndikojnë në sjelljen e aktorëve ekonomikë realë në terren.

## **II. KONTEKSTI**

### *A. Deindustrializimi i Kosovës*

Për të eksploruar pozicionin e NSH-ve në ekonominë e Kosovës LLA-ja ndërmorri hulumtime të rëndësishme në terren në komunën e Pejës,<sup>7</sup> po ashtu edhe një seri rastesh të studiuara në nivel ndërmarrjesh në të gjithë Kosovën. Ajo që doli nga kërkimet ishte një pasqyrë e plotë e deindustrializimit pothuajse total. Gjatë dy dekadave të zhvillimit industrial në Kosovë nga mesi i viteve 60 deri nga mesi i viteve 80, Peja ishte një qendër e rëndësishme prodhuese. Sot ekonomia e saj i ngjan shumë Pejës para socializmit, përpara së të fillonte

<sup>7</sup> Rasti studimor lidhur me deindustrializimin në Pejë iu paraqit stafit të UNMIK-ut dhe Shtyllës së BE-së në shkurt të vitit 2002. Një version i rishikuar i kohëve të fundit do të dalë në raportin e ardhshëm të LLA – ESI.

deindustrializimi: tregtarë të vegjël, zejtari, bujqësi bazë dhe një numër i vogël njësisish të vogla prodhuese private, ku dallohen një fabrikë tullash dhe një furrë buke. Strukturat industriale të zhvilluara gjatë socializmit jugosllav janë shkatëruar.

Para dy dekadash, në NSH-të në Pejë ishin të punësuar 10,200 persona.<sup>8</sup> Sot jo më shumë se 1,500 persona punësohen rregullisht nga të njëjtat ndërmarrje. Vetëm një numër i vogël i tyre vazhdon akoma të ketë një lloj prodhimtarie.

Në epokën socialiste një fabrikë që prodhonte pjesë automjetesh për kombinatin gjigand të Zastavës në Serbi ishte xhevahiri industrial i zonës dhe një nga NSH-të më të mëdha në Kosovë.<sup>9</sup> Sot ky pozicion mbahet nga berraria e Pejës e cila me 520 punëtorë siguron 1/3 të punësimit në sektorin shoqëror. Tri ndërmarrjet e tjera që janë në gjendje të paguajën rroga të rregullta janë një furrë buke, një fabrikë tullash dhe një kompani tregtare, 17 Nëntori, e cila vetë nuk bën tregti por e ka lëshuar me qera shtëpinë e mallrave në qendër të Pejës si dhe një numër të madh dyqanesh në rajonin e Pejës. NSH-të e mbetura janë të angazhuara në prodhimtari sporadike, shesin stoqe të vjetra ose i sigurojnë të ardhurat e tyre nga dhënia me qera e dyqaneve dhe lokaleve të prodhimtarisë sektorit privat.

Në të gjithë Kosovën është e njëjta situatë. Vetëm një përqindje e vogël e fuqisë aktive punëtoresh është e punësuar nga NSH-të. Duket se shumë më pak se 20,000 persona, nga një popullsi prej pothuaj 1.9 milion, marrin të ardhura të rregullta nga një NSH.<sup>10</sup> Në një shoqëri ku gjysma e popullsisë është nën 25 vjeç, pjesa më e madhe e njerëzve nuk ka punuar asnjëherë në një NSH.

Me pak fjalë periudha e zhvillimit industrial socialist në retrospektivë duket se ka qenë një episod i shkurtër në historinë ekonomike të Kosovës. Natyrisht që kanë mbetur akoma shumë nga pasojat e tij shoqërore, në mënyrë të veçantë migrimi masiv i popullsisë nga fshatrat në qendrat urbane.

Rënia e sektorit industrial e cila filloi në fillim të viteve 80, ka disa domethënie të rëndësishme. Është fakt ironik që njëra prej tyre ka natyrë pozitive. Kosova tashmë e ka kaluar fazën më të vështirë të reduktimit të vendeve të punës në ndërmarrjet e paqëndrueshme. Në vendet e tjera të ish-Jugosllavisë dhe në të gjithë Evropën post-komuniste, shtetet po luftojnë me zhvendosjet e mëdha shoqërore të shkaktuara nga rënia e industrive të mëdha. Qytete të tëra që mvaren nga gjigandët industrialë që po kalben, po hyjnë në një periudhë degradimi urban dhe përçarja e subvencioneve shtetërore në firma me humbje po bëhet me një kosto sociale tepër të lartë. Punëtorët e përfshirë në një mjedis pune të caktuar po hasin vështirësi gjatë zhvendosjes drejt sektorit privat.

Megjithatë, në Kosovë, industrializimi shoqëror ka ndodhur më vonë dhe në shkallë më të ulët sesa kudo tjetër në ish-Jugosllavi. Në këto industri ka punuar një përqindje shumë më e ulët e fuqisë punëtoresh. Për më tepër, gjatë dekadës së dhimbshme ose që pasoi humbjen e autonomisë së Kosovës, pjesës më të madhe të familjeve kosovare iu desh të zhvillonte një

<sup>8</sup> Në atë kohë u punësuan gjithsej rreth 75,000 persona në NSH-të në të gjithë Kosovën.

<sup>9</sup> Gjatë historisë së saj ajo ka qenë një furnizues i pasigurtë që i është nënshtruar problemeve industriale të vazhdueshme. Në janar të vitit 1989, nga 320 shasi kamionësh që i janë dërguar IVECO-s (nëndegë e kamionëve FIAT) nga Ramiz Sadiku, 180 prej tyre janë kthyer mbrapsht pasi kanë qenë nën nivelin e duhur. Për të dhëna të mëtejshme shiko raportin e ardhshëm të LLA –ESI-t *Deindustrializimi i Kosovës – rast studimor i Pejës*, si dhe Michael Palairt, *Ramiz Sadiku: Një rast studimor në Industrializimin e Kosovës*, Studime Sovjetike, vll. 44, Nr. 5, 1992.

<sup>10</sup> Duke bërë një krahasim, numri total i njerëzve të punësuar në industri gjatë fundit të viteve 40 ishte rreth 17,000.



strategji ekonomike për mbijetesë që nuk varej nga sistemi socialist, ku kryesisht përfshihej tregtia, bujqësia bazë dhe një fuqi punëtore e madhe migruese. Ky avantazh krahasues e shpjegon qartë shpejtësinë me të cilën është zhvilluar ekonomia private e Kosovës në fillim të viteve 90 dhe regresin e saj pasluftës.

Domethënia tjetër e rëndësishme është se pas dy dekadash dekapitalizimi të rëndë të NSH-ve kosovare me stokun industrial të papërdorshëm dhe me strukturat e përbashkëta tepër jo-funksionale, privatizimi në Kosovë do të jetë një proces i daljes së organizuar në pension të pjesës më të madhe të NSH-ve. Ekzistojnë pak aktivitete në vazhdim të cilat kanë vlera dhe që kanë gjasa të tërheqin vëmendjen e një investuesi serioz. Në këto rrethana, forma më efektive e privatizimit është likuidimi efikas i pasurive individuale, në mënyrë të veçantë pronave të patundshme.

### *B. Rënia e pronës shoqërore*

Ndërkohë që pjesa më e madhe e NSH-ve nuk ka më rëndësi në aspektin ekonomik, ato vazhdojnë të ekzistojnë si subjekte ligjore dhe sociale. Megjithatë, institucioni i pronës shoqërore, në të cilin NSH-të kanë qenë pjesë përbërëse, është shpërbërë. Tradicionalisht NSH-të janë qeverisur nga një kornizë ligjore komplekse që rregullonte identitetin e tyre, administrimin dhe të ‘drejtat e tyre të përdorimit’ mbi pronën shoqërore. NSH-ve u është dhënë e drejta për të përdorur pronat shoqërore specifikisht për qëllime të prodhimit shoqëror, siç përcaktohen në statutet e kompanive. Ata nuk kishin të drejtë të përdornin pronat shoqërore për asnjë qëllim tjetër dhe aq më pak t’i shisnin ato apo t’i lëshonin me qera për të siguruar përfitime.

Në letër kjo kornizë ligjore vazhdon të jetë ligji i aplikueshëm në Kosovë. Megjithatë në praktikë, duke mos pasur asnjë institucion publik të gatshëm për ta zbatuar atë, NSH-të tani e gjejnë veten duke operuar në një vakum ligjor.

Një ndarje domethënëse e pasurive të patundshme komerciale të Kosovës – dyqanet, magazinat, tokat – kontrollohen nga NSH-të, pjesa më e madhe e saj në zonat urbane ku një pjesë e vogël e lokaleve të biznesit e bën atë jashtëzakonisht të vlefshme në tregun e hapur. Çmimet e pasurive të patundshme në Kosovë, veçanërisht për tokat e shfrytëzuara nga infrastruktura, mund të jenë jashtëzakonisht të larta. NSH Dardania, për shembull, i jep me qera një kompanie private në Prishtinë Besholli Commerce, 1.11 ha tokë për 7,500 € në muaj. Fabrika e metalit Eurometal në Ferizaj i jep me qera 8 hektarë tokë kontraktuesit të qeverisë amerikane Brown & Root për 12,000 € në muaj. Në qytete çmimi i qerasë për një dyqan pa një linjë telefoni apo ujë të rrjedhshëm mund të jetë po aq i lartë sa në mes të Berlinit.

Jo çuditërisht NSH-të janë përgjigjur duke u kthyer në agjenci pasurish të patundshme, duke i vënë sektorit privat çmime qeraje të larta. Për pjesën më të madhe të tyre kjo e ardhur nga qeraja është arsyeja kryesore për ekzistencën e tyre të vazhdueshme. Kjo sjell një burim të ardhurash të pa taksuara që përdoret për të paguar punëtorët e mbetur me pjesën tjetër që zhduket në duart private.

Për shembull kompania tregtare ‘17 Nëntori’ në Pejë, drejtor i së cilës është shefi i partisë së PDK-së për komunën, e ka ndaluar tregtinë nën emrin e tij. Në vend të kësaj ajo lëshon me qera 107 lokalet e veta, duke përfshirë 49 dyqanet tek ‘Shtëpia e Mallrave’ (shopping mall), me nga 100 € deri 820 € në muaj, duke sjellë të ardhura prej rreth 24,000 € në muaj. Qiramarrësit kërkohet të punësojnë të paktën një nga 290 punëtorët e 17 Nëntorit me një rrogë

mujore prej 175 €, plus mëngjesin. Kompania tregtare 'Liria' në Prizren gjithashtu e ka ndaluar tregtinë dhe tani lëshon me qera rreth 100 dyqane, duke i shpërndarë të ardhurat ndërmjet punëtorëve të saj. Shpenzimet e sektorit privat janë substanciale dhe përbëjnë një barrierë apo pengesë për hyrjen në treg. Në Ferizaj një familje e cila lëshon me qera një dyqan prej 150m<sup>2</sup> në një vend kryesor nga një NSH për 1,550 € në muaj është e detyruar të punësojë katër ish-punëtorë të NSH-së për 150 € secilin, edhe pse ata nuk vijnë në punë.

Pasiguria ligjore është edhe më shkatërruese sesa çmimet e larta të qerave. Për shkak se qeratë e pasurive të patundshme në pronësi shoqërore janë teknikisht të paligjshme, qiramarrësi është në mëshirë të NSH-së, duke mos gëzuar mbrojtje ligjore të asnjë lloji. Qeratë janë afatshkurtra dhe të pasigurta, duke vepruar si element kryesor dekurajues apo zhbindës për investimin në biznes. Për shembull kompania private për mbushjen e pijeve joalkolike Fluidi lëshon me qera një holl fabrike nga Fabrika e Baterive IBG në Gjilan për 4 € për m<sup>2</sup>. Kompania ka investuar shumë në këto lokale, duke rinovuar transformatorët elektrikë, duke ngritur çatinë për të krijuar hapësirë për makineritë e mëdha madje dhe duke ndërtuar një ndërtesë të re. Megjithatë përgjigjia e NSH-së është rritja e qerasë, duke e detyruar fabrikën të kërkojë për lokale të tjera. Në këtë mjedis, interesat komerciale me lidhje në administrimin e NSH-ve, ose partive politike që qëndrojnë pas tyre, gëzojnë një avantazh krahasues të dukshëm.

Në disa raste, NSH-të lëshojnë jo vetëm pasuri të patundshme, por gjithashtu njësi të tëra prodhuese, të plotësuara me punëtorë, në atë që quhet një lloj 'komercializimi' jo formal. Në Prizren, fabrika e tullave Ramiz Sadiku përgatiti një tender, shqyrtoi 9 oferta dhe më pas nënshkroi marrëveshjen e vet të koncesionit me investuesit privat Fazli Kryeziu, drejtor dhe pronar i kompanisë Pagarusha me bazë në Prizren. Kompania e ndërtimit '1 Maji' në Rahovec lëshon me qera tokë për njerëz që kanë separacione për rërë dhe zhavor gjatë shtratit të lumit Drin. Në Pejë, një kooperativë bujqësore ka nënshkruar një marrëveshje 10-vjeçare për dhënien me qera të 500 ha tokë plus stallat e saj në Vitomerica bashkë me kompaninë private Fructus.

Për shkak të çmimeve të larta të qerasë edhe NSH-të më zhgënjyese, biznesi kryesor i të cilave ka kohë që ka pushuar së funksionuari, mund të kontrollojë burime të rëndësishme të ardhurash. Si rezultat i kësaj, lufta për kontrollin e vetë NSH-ve është një biznes serioz, por që ndodh shumë jashtë çdo sistemi ligjor të krijuar. Në Prishtinë, një ish-drejtuës njësie në fabrikën Kosovabrick ka arritur të sigurojë një kontroll mbi rreth gjysmën e lokaleve të NSH-ve, të cilat ai ua jep me qera ndërmarrjeve të ndryshme private. UNMIK-u e ka pranuar këtë marrëveshje në heshtje duke e komercializuar gjysmën tjetër të pronës, duke përfshirë dhe njësinë prodhuese. Në rastin e NSH-së Agromorava në Viti, e cila kontrollon përafërsisht 1,000 ha tokë të vlefshme bujqësore, punëtorët janë ankuar në UNMIK se drejtori, i mbështetur nga një grup prej dhjetë punëtorësh, është duke u përpjekur që të shesë tokë dhe t'i fusë të ardhurat në xhep. Në 'vetëmbrojtje', punëtorët po ruajnë tokën ndaj shkeljeve nga ana e drejtorit. Në Gjakovë, në kombinatin bujqësor Ereniku, ka shpërthyer një luftë e hidhur ndërmjet drejtorit të vetëemëruar të pasluftës, Masar Lluka dhe menaxherit të përgjithshëm Shahin Dula të emëruar nga këshilli i punëtorëve në mars të vitit 2001 dhe të rizgjedhur në shkurt të vitit 2002. Punëtorët, në katër nga gjashtë divizionet e kompanisë, e mbështesin Z. Dula, ndërsa pjesa që mbetet mbështet Z. Lluka, i cili vazhdon të nxjerrë përfitime nga dhënia me qera e një pjesë të tokës së kompanisë. Të dy këta persona kohët e fundit kaluan disa ditë nën arrest të policisë, pasi u gjetën fajtorë për shkelje të rendit publik nga gjykata komunale.

Ka raste të shumta në të gjithë Kosovën kur toka është e zënë apo dhënë me qera nga interesa private me kurrfarë titulli ligjor. Për shembull shtëpia e mallrave në Podujevë është marrë nga PDK-ja dhe është dhënë me qera. PDK-ja si pasojë ka informuar si komunën ashtu dhe DTI-në se kishte nënshkruar një marrëveshje qeraje me drejtorin e NSH-së dhe se ata ishin shumë vonë për të ndërhyrë. Në qendër të Prizrenit, një ndërtesë dykatëshe ku ndodhet butiku Punto është marrë nga një individ privat i cili pretendoi se e ka marrë atë me qera nga kisha ortodokse serbe. Duke mos qenë në gjendje të japin ndonjë dokumentacion për këtë qera, posedimi i vazhdueshëm i tij çon deri në mundësinë e të afërmeve të tij dhe miqve për të mbajtur larg inspektorët komunalë.

Disa NSH madje janë duke i shitur pasuritë e tyre në mënyrë të paligjshme. NSH Ereniku në Gjakovë shiti një pjesë të tokave të saj me inkurajimin e UNMIK-ut edhe pse UNMIK-u zakonisht jep veton për shitjen e pasurive.<sup>11</sup> Ndërmarrje të tjera i kanë përdorur të ardhurat e tyre për të përfunduar praktikën socialiste të ndërtimit të apartamenteve për ‘punonjësit’ e tyre. Grand Hoteli në Prishtinë, për shembull, ka ndërtuar një bllok të tërë apartamentesh në zemër të kryeqytetit pranë zyrave qendrore të OSBE-së, në tokë komunale e cila më përpara ka strehuar një stadium sportesh.

Pa një qeveri në gjendje të zbatojë të drejtat e pronës, pronarët e dyqaneve dhe biznesmenët e vegjël në të gjithë Kosovën po drejtohen drejt kompanive private të sigurimit për të mbrojtur interesat e tyre. Mungesa e titujve të pronës krejtësisht të pazbatueshëm krijon një treg për agjencitë private të sigurimit, duke zëvendësuar shtetin e dobët. I gjithë ambjenti është në favor të shfaqjes së fenomenit të reketimit (fenomeni i pagesës së paligjshme për mbrojtje të imponuar).

Shkurtimisht, korniza kushtetuese dhe ajo institucionale që e rrethon pronën shoqërore është disintegruar duke krijuar një liri për të gjithë në mes atyre që janë mjaft të fortë për të marrë kontroll mbi NSH-të ose pronat e tyre. Marrëdhëniet e pronës në Kosovë janë një funksion kompetencash apo pushteti, më shumë sesa ligj. Sistemi formal i pronës që pason është ekonomikisht jo i efektshëm, përçarës nga ana shoqërore dhe krejtësisht i padrejtë. Qeraja që i paguhet individëve që kontrollojnë NSH-të nuk është as transaksion tregu dhe as taksë për një institucion publik; më shumë se çdo gjë tjetër, ajo i përngjan detyrimeve feudale që i janë paguar një *seigneur-i*.

### **III. UNMIK – KUJDESTAR I BESUESHËM I PRONËS SHOQËRORE**

Në mes të gjithë këtij kaosi, pyetja më e qartë është: Çfarë ka ndodhur me përgjegjësitë e UNMIK-ut si kujdestar i besueshëm i pronës shoqërore? Që nga viti 1999, nëpër divisionet institucionale të ndryshme të tij, UNMIK-u ka përshtatur katër politika mjaft të ndryshme drejt NSH-ve, ndonjëherë njëkohësisht.<sup>12</sup>

1. Që nga fundi i vitit 1999 deri në fund të vitit 2000, administratorët e KB-së në nivelin komunal u përpoqën të drejtojnë aktivitetet e ndërmarrjeve në territorin e tyre duke rivendosur kërkesat raportuese të kohës socialiste si dhe kontrollet institucionale.

<sup>11</sup> Këshilltari ligjor i DTI-së Allan Shin u tha drejtuesve të NSH-ve në Gjakovë në maj të vitit 2001 se shitja e pasurive është e pranueshme për atë kohë sa të mos përfshinte shitjen e ‘pasurive themelore’ dhe që nuk e kalonin vlerën 1 milion DM.

<sup>12</sup> Për arsye politike kompleksi i minierave të Treptës është trajtuar gjithmonë në mënyrë të veçantë dhe për pjesën më të madhe të vitit 2000 u duk se po monopolizonte politikën ekonomike të UNMIK-ut.

2. Që nga fillimi i vitit 2001, Departamenti i Tregtisë dhe Industrisë i sapo krijuar (DTI-ja), duke vepruar nën Shtyllën e BE-së, eksperimentoi duke prezantuar menaxhimin e përkohshëm ndërkombëtar, një strategji e përdorur në gjashtë raste të ndryshme.
3. Që nga marsi i viti 2001, DTI-ja në bashkëpunim me administratorët komunalë të KB-së parashikoi të riformonte qeverisjen e përbashkët të NSH-ve duke e riprezantuar sistemin e vjetër të administrimit me anë të këshillave të punëtorëve, të cilët zgjidheshin direkt nga fuqia punëtore e secilës ndërmarrje – një sistem që dikur ka qenë guri i themelit të socializimit vetëadministrues jugosllav.
4. Paralelisht me këtë, DTI-ja zhvilloi një politikë të dhënies së marrëveshjeve të koncesionit të NSH-ve tek investuesit privatë. Kjo politikë e cila u bë e njohur si ‘komercializim’, ishte hartuar të zgjidhte ankesat ligjore rreth privatizimit direkt të imponuar nga Zyra Ligjore e KB-së në New York.

#### *A. Kontrollat e ndërmarrjeve pasluftës*

Menjëherë në periudhën pas luftës, çështja se kush i kontrollonte NSH-të ishte vendosur kryesisht me forcë. Me tërheqjen e administratës serbe nga Kosova, ‘drejtorët’ kosovarë të ndërmarrjeve morën kontrollin e pasurive, shpesh me mbështetjen e ‘qeverisë së përkohshme’ të vetë emëruar të UÇK-së dhe strukturave të saj komunale. Në shumë raste, drejtuesit e rinj ishin në gjendje të nxirrnin kapital punues duke shitur stoqe ose duke dhënë me qera lokale. Në kaosin e asaj periudhe të hershme, drejtorët gjithashtu kontrollonin rindërtimin e fuqisë punëtore, shpesh duke u zgjedhur në mënyrë arbitrare ndërmjet atyre punëtorëve të paraluftës ose madje edhe të kolektivit punëtor të kohës para viteve 90. Punëtorët besnikë ndaj drejtuesve të rinj shpërbleheshin me të ardhura të vazhdueshme; të tjerët, duke përfshirë sigurisht serbët e shpërngulur, u zhdukën nga librat/regjistrat.

Pjesa më e madhe e drejtuesve të NSH-ve në rajonin e Pejës janë zgjedhur nga qeveria e përkohshme, e udhëhequr nga Hasan Meta (president) dhe Ethem Çeku (shef i bordit administrativ). Një nga aktet e para të autoriteteve të para ishte nxjerrja e licensave për operimin e kompanive apo lokaleve të caktuara. Dyqanet në qytetin e Pejës ishin mbushur me posterë duke proklamuar se janë ‘pronë e shtetit’ (pronë publike). Në nëntor të vitit 1999, autoriteti i të ardhurave të UNMIK-ut zbuloi të paktën një “sistem paralel gjithëpërfshirës për mbledhjen e taksave” që operon në rajonin e Pejës. Gjashtë prej tetë bizneseve të studiuara u është kërkuar të paguajnë taksa për qeverinë e përkohshme të Kosovës. Tre prej tyre që i kishin bërë pagesat kishin marrë fatura dhe regjistrat për kryerjen e pagesave.

Kur administrata komunale e UNMIK-ut filloi punën e saj në fillim të vitit 2000, administratorët komunalë u përpoqën të sjellin pak rregull në këtë sektor duke vënë kontroll komunal ndaj NSH-ve. Në Jugosllavinë socialiste, NSH-të ishin të detyruara të raportonin në komunë rregullisht. Nëse një ndërmarrje nuk arrinte të përputhej me një pafundësi rregullash të vetëadministrimit, ishte komuna ajo që ndërhynte për të mbrojtur interesin publik. Nën Ligjin mbi Ndërmarrjet të vitit 1988, në rast se një ndërmarrje shoqërore “nuk i përdor fondet shoqërore si duhet apo nuk i rinovon në mënyrë permanente fondet sociale, nuk i rrit dhe nuk i promovon ato” ose në rast se, duke kryer biznes “kundër rregulloreve si dhe dekretive të vetëadministrimit, kjo i shkakton një dëm në shkallë më të madhe bashkësisë sociale”, komuna ishte e detyruar të ndërmernte një gamë masash. Këto përfshinin heqjen e bordit

drejtues, heqjen e punëtorëve nga pozicionet drejtuese, shpërndarjen e këshillit të punëtorëve apo komisionit disiplinor, duke i kushtëzuar përkohësisht të drejtat për vetëadministrim të punëtorëve ose duke emëruar një organ të ri, të përkohshëm drejtues.<sup>13</sup>

Në Pejë, këshilli komunal i kryesuar nga UNMIK-u filloi të thërriste drejtuesit e NSH-ve për të raportuar mbi aktivitetet e tyre. Me datë 12 prill 2000, u paraqitën raportet mbi fabrikat e tullave dhe të baterive të Pejës. Procesverbali i këshillit theksoi se “megjithëse pikat ligjore kërkojnë kohë për t’u zgjidhur anëtarët e njohën përgjegjësinë e tyre përmes bordit administrativ si dhe këshillit komunal për t’u siguruar që të kishte administrim profesional për zhvillimin e ndërmarrjeve të vlefshme.”<sup>14</sup> Kjo ishte “menduar si mjet i parë për trajtimin e objektivit të politikës supreme për të ringjallur ekonominë vendase”.<sup>15</sup> Siç shpjegoi një zyrtar komunal i UNMIK-ut në maj të vitit 2000, këshilli komunal “ka mandat për të emëruar dhe hequr nga puna drejtuesit më të lartë dhe raportet mujore për secilën ndërmarrje shoqërore i dërgohen drejtorit të ekonomisë dhe bordit administrativ për shqyrtim dhe aprovim”.<sup>16</sup> Drejtori i ekonomisë në Pejë, një kosovar, kishte shtatë inspektorë në dispozicion për zbatimin e kësaj politike.

Në të njëjtën kohë, komuna u përpoq t’ua bëjë të njohur autoritetin e saj dyqaneve të NSH-ve në qytetin e Pejës. Sipas ligjit të aplikueshëm, komuna ka ‘të drejtën e heqjes’ ndaj pronës shoqërore, ndërsa ndaj NSH-së mban vetëm ‘të drejtën e përdorimit’ të lokaleve për aktivitetet e veta tregtare. Ligji nuk i lejon një ‘përdoruesi’ të një prone shoqërore ta lërë atë për profite. Komuna vuri çmime qeraje nëpër zona të ndryshme të qytetit, duke variuar nga 2.5 €m<sup>2</sup> në rrethina, 10 €m<sup>2</sup> në tregun e vjetër dhe filloi të konkludonte kontratat e veta me qera, duke i mbledhur të ardhurat në një llogari të veçantë. Megjithatë, në praktikë nuk kontrolloi kurrë më shumë se një fraksion të dyqaneve të cilat ishin në pyetje.

Sistemi i mbikqyrjes së përbashkët kosovare dhe UNMIK-ut mbi NSH-të në nivelin komunal mbërriti fundin nga fundi i vitit 2000 pa arritur ndonjëherë marrjen e kontrollit të ndërmarrjeve. Birraria e Pejës, për të dhënë një shembull, është thirrur shpesh për të raportuar në këshill, gjë e cila vërejti se “raportimi financiar i saj ka qenë mjaft i varfër”.<sup>17</sup> UNMIK-u nuk tentoi pothuajse askund që të sfidojë emërimin e drejtorëve nga ana e strukturave të pushtetit të pasluftës. Siç tha zëvendës administratori komunal i UNMIK-ut për Gjilanin, “ishte vendosur që duke parë prioritetet e tjera ne duhet të lejonim drejtorët ekzistues të rrinin në postet e tyre për aq kohë sa ata nuk shkaktonin probleme”.<sup>18</sup>

## *B. DTI-ja dhe ringjallja e demokracisë në vendet e punës*

Periudha e mbikqyrjes komunale të NSH-ve përfundoi, në mënyrë mjaft paradoksale, me zgjedhjet e para komunale në dhjetor të vitit 2000. Krijimi i një qeverie të re komunale të legjitimizuar në mënyrë demokratike solli një sërë ‘problemesh’ të tjera në sektorin e NSH-ve. Administrata e re e LDK-së në Podujevë dhe Gjilan lëvizi shpejt për të zëvendësuar drejtorët e ndërmarrjeve të emëruar nga kundërshtarët kryesorë të tyre, PDK-ja.

<sup>13</sup> Ligji mbi ndërmarrjet, 1988, neni 79.

<sup>14</sup> Takimi i këshillit të Pejës, procesverbali, 12 prill 2000.

<sup>15</sup> Takimi i këshillit të Pejës, procesverbali, 12 prill 2000.

<sup>16</sup> Takimi i këshillit të Pejës, procesverbali, 31 maj 2000.

<sup>17</sup> Takimi i këshillit të Pejës, 19 korrik 2000. Këshilli vlerësoi “sponsorizimin dhe e mbështeti kompaninë gjithashtu e dhënë si pjesë e dedikimit të saj ndaj qytetit dhe administratës”.

<sup>18</sup> Zv. administratori komunal në Gjilan, 14 mars 2001.

Komunat e tjera filluan të ndiqnin paditë. Skena ishte krijuar për një luftë për kontroll me rrezik të mundshëm nga elemente të ndryshme të spektrik politik kosovar. Këto konfrontime e detyruan UNMIK-un të përcaktojë një politikë më aktive.

Brenda UNMIK-ut kishte arsye të tjera, të cilat kërkuan zhvillimin e një politike të re. Departamenti i Tregtisë dhe Industrisë (DTI-ja) ishte krijuar në dhjetor të vitit 2000, duke kërkuar një ndarje përgjegjësish ndërmjet DTI-së dhe administratorëve komunalë, të cilët iu përgjigjën Departamentit të Administratës Vendase. DTI-ja po mbikqyrte një pozicion në debatin e gjerë ligjor për të parë nëse ishte i mundur privatizimi brenda qëllimit të administratës së përkohshme në Kosovë. Zhvillimi i politikës brenda DTI-së ishte gjithashtu i ndikuar nga njohjet politike të bashkë-kryetarëve të tij pasues kosovarë, të cilët të gjithë ishin emëruar nga PDK-ja dhe kundërshtonte përpjekjet e komunave të kontrolluara nga LDK-ja për të ndryshuar drejtuesit e ndërmarrjeve të cilit ishin besnikë ndaj PDK-së.

Politika që doli në fillim të viteve 2001 kishte tre tipare kryesore. Së pari përfshinte përjashtimin e të gjithë kontrollit të komunave mbi NSH-të. Një memorandum i arrirë në shkurt të vitit 2001 ndërmjet DTI-së dhe Departamentit të Administratës Vendase pohoi (gabimisht, siç ngjau) që ligji i aplikueshëm “nuk siguron asnjë pushtet për organet qeveritare, në asnjë nivel, për të administruar NSH-të”.<sup>19</sup> Së dyti, për të zgjidhur mosmarrëveshjet rreth drejtimit të NSH-ve, DTI-ja ringjalli institucionin e këshillit të punëtorëve si kryeorgan ekzekutiv, i zgjedhur nga i gjithë kolektivi i punëtorëve. Kur ishte e nevojshme për të zgjidhur mosmarrëveshje të caktuara, DTI-ja i drejtohej administratës së përkohshme ndërkombëtare për ndërmarrje të caktuara për të përgatitur rrugën për zgjedhjet e këshillit të punëtorëve. Së treti, DTI-ja dhe DAV-ja filluan të kërkojnë për investues të interesuar në marrjen me qera të NSH-ve nën marrëveshjet e koncesionit, si një strategji e përkohshme për të tërhequr investime dhe për të krijuar vende pune deri sa të pastrohej rruga për privatizim real.<sup>20</sup>

DTI-ja nuk ka qenë kurrë krejtësisht autonome në zgjedhjen e këtyre politikave. Kompetenca për të ndërhyrë tek NSH-të mbeti e rezervuar për vetë PSSP-në dhe DTI-së i kërkohej që nëpërmjet rregulloreve të saj themeluese të kërkonte në çdo rast “vendosmëri nga ana e PSSP-së që një NSH e caktuar të administrohet nga UNMIK-u”.<sup>21</sup> Edhe pse UNMIK-u nuk kishte mekanizma të tjera se DTI-ja në dispozicion të tij për t’iu përgjigjur mosmarrëveshjeve në nivel ndërmarrjesh, Zyra e Këshilltarit Ligjor padyshim ngurroi që të autorizonte ndërhyrjen e DTI-së në instanca të ndryshme. Kjo ndarje kompetencash dhe përgjegjësish solli një vakum institucional brenda UNMIK-ut në ushtrimin e rolit të tij të kujdestarit.

Testi i parë i vërtetë për DTI-në – dhe një moment përcaktues në formimin e politikës së saj – erdhi në fillim të vitit 2001 kur punëtorët e fabrikës së përpunimit të metalit “Zahir Pajaziti” në Podujevë u ngritën kundër drejtuesve që kishin lidhje me PDK-në. Në nxitje të administratës së re komunale, u krijua një komitet *ad-hoc* (i përkohshëm) punëtorësh, i cili

<sup>19</sup> Memoja e DTI-së i referohet Ligjit mbi Ndërmarrjet me ndryshimet e bëra në vitin 1990, si pjesë e një seri reformash ligjore për bashkimin e NSH-ve. Në fakt ligji i aplikueshëm ishte teksti origjinal i RSFJ-së i vitit 1988, i cili përmbante dispozitat mbi kontrollin komunal të NSH-ve të cituar më sipër. Ky gabim çoi në tensione të konsiderueshme dhe keqkuptime ndërmjet administratorëve komunalë të UNMIK-ut.

<sup>20</sup> Për zbatimin e kësaj strategjie të ‘komercializimit’, Shtyllat 2 dhe 4 të UNMIK-ut bashkëpunuan në krijimin e Ekipeve Rajonale për Transformimin e Biznesit të cilat ishin përgjegjëse për identifikimin e kandidatëve premtues për koncesion. Ata përfshinë përfaqësues nga administratorët rajonalë të KB-së, DTI-ja, DAV-ja dhe ekspertët e Menaxhimit të Biznesit të caktuar nga Agjencia Ndërkombëtare Kanadeze për Zhvillim.

<sup>21</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2000/63, Neni 2.2.

insistoi që drejtuesit të shkarkoheshin të tërë dhe të zëvendësoheshin me ata që ky komitet do t'i caktonte vetë. DTI-ja gjeti një zgjidhje për mosmarrëveshjen në ligjin e vitit 1988 të RSFJ-së mbi ndërmarrjet dhe statutet e vetë kompanisë.<sup>22</sup> Këto përcaktuan zgjedhjen e këshillave të punëtorëve, që në anën tjetër do të emëronte një drejtor të ri. DTI-ja emëroi një pjesëtar të stafit të saj ndërkombëtar si administrator të përkohshëm, për aq kohë sa të mund të organizoheshin zgjedhjet nëpër vendet e punës.

Ky u bë rasti i parë në të cilin UNMIK-u ndihmoi të organizonte dhe monitorizonte zgjedhjet e këshillave të punëtorëve. Një takim i përgjithshëm i fuqisë punëtore vendosi për numrin e përfaqësuesve në këshillin e punëtorëve dhe ndarjen e përfaqësuesve në divizione të ndryshme në kompani. U emërua një komision për të përgatitur listat e votuesve, që në fillim përmbanin 400 emra por që më vonë u reduktua në 350, duke përjashtuar punëtorët në pushim pa pagesë (dhe për këtë arsye duke dalë jashtë kornizës ligjore të ligjit të vitit 1988). Zgjedhjet u mbajtën në mëcën e kompanisë më 8 mars 2001. Secili punëtor plotësoi një fletë votimi të shtypur nga komuna dhe të nënshkruar nga një mbikqyrës i brendshëm dhe u hodh në kutinë e votimit të ofruar nga OSBE-ja.

Në fund, zgjedhjet legjitimuan ndërhyrjen e komunës në kompani. Katër ditë pas zgjedhjeve, këshilli i punëtorëve në takimin e tij të parë të rregullt tentoi të shkarkonte të gjithë ekipin drejtues. Administratori i DTI-së ndërhyri për ta parandaluar këtë, por lejoi që drejtori të zëvendësohej nga ish shefi i tij kontabilist, i cili ishte kandidat i favorizuar nga administrata komunale e LDK-së. Administratori i DTI-së prezantoi disa rregulla që kishin të bënin me administrimin e parave, por përndryshe e kufizoi rolin e saj në atë të një këshilltari në pritje të emërimit të një ekipi drejtues të përhershëm.

Me krijimin e strategjisë së DTI-së për zgjidhjen e konflikteve të NSH-ve, rastet pasuese ndoqën një rrugë të ngjashme. Në kompaninë e ndërtimit 'Morava e Binçës' në Gjilan, punëtorët u rebeluan kundër një drejtuesi të emëruar nga PDK-ja i cili nuk kishte arritur t'i paguante rrogat rregullisht. Me datë 9 prill 2001, DTI-ja emëroi një administrator ndërkombëtar të përkohshëm, i cili ishte udhëzuar që të përdorte kompetencat e tij me masë deri në zgjedhjen e drejtuesit dhe një këshilli punëtorësh të përhershëm.<sup>23</sup> Administratori caktoi kandidatin e favorizuar nga ana e administratës komunale të LDK-së si zëvendës të përkohshëm, deri sa ai të zgjidhej në mënyrë të rregullt.

Si rezultat drejtimi i përkohshëm ndërkombëtar rezultoi në një mjet ndërhyrës intensiv por krejtësisht sipërfaqësor. Zgjedhjet për këshillin e punëtorëve përfunduan duke e miratuar ekipin drejtues të favorizuar nga ana e komunave. Drejtimi i huaj ishte vendosur vetëm në gjashtë kompani të ndryshme gjatë dy viteve të fundit, tre prej tyre në Gjilan. Megjithatë nuk bëri më shumë se ruajtja e qetësisë – në asnjë rast nuk ka pasur përpjekje për ristrukturimin e ndonjë ndërmarrjeje apo për prezantimin e një plani të ri biznesi.

Që në fillim të vitit 2001, DTI-ja ka dedikuar një pjesë të mirë të burimeve të saj në terren për promovimin e zgjedhjeve të këshillave të punëtorëve në të gjithë Kosovën, me përjashtim të

<sup>22</sup> Shiko përmbledhjen e DTI-së, 'Legjitimimi i këshillave të punëtorëve të NSH-ve dhe organeve drejtuese', 2001.

<sup>23</sup> Duke rishqyrtuar gjendjen financiare të kompanisë, ai zbuloi që 400,000€ ishin 'zhdukur' nga llogaria e kompanisë. Mungoni fatura të shumta, në veçanti për sa i përket punëve ndërtimore në një barakë të TMK-së, një shkollë dhe disa buste përkujtimore.

Kosovës veriore dhe enklavave serbe. Në muajin korrik 2002, një total prej 110 zgjedhesh të këshillave të punëtorëve janë monitoruar nga DTI-ja.<sup>24</sup>

**Tabela 1: Pasqyrë e drejtimit të përkohshëm të DTI-së, 2001-2002**

<b>Ndërmarrja</b>	<b>Rajoni</b>	<b>Data</b>	<b>Arsyeja</b>
Zahir Pajaziti	Podujevë	Shkurt 2001-Maj 2001	Pushimi nga puna i drejtorit nga ana e punëtorëve
Morava e Binçës	Gjilan	Prill 2001-Gusht 2001	Ndërhyrja e autoriteteve të komunës për të emëruar një drejtor të ri
Jugoterm	Gjilan	Qershor 2001-Janar 2002	Ndërhyrja e autoriteteve të komunës për të emëruar një drejtor të ri
IBG Fabrika e baterive	Gjilan	Qershor 2001-Dhjetor 2002	Ndërhyrja e autoriteteve të komunës për të emëruar një drejtor të ri
Trasing	Prishtinë	Dhjetor 2001 (në vazhdim)	Ndarje e paligjshme e gurores nga NSH Trasing
Mirusha	Pejë	Prill 2002 (në vazhdim)	Anullimi i kontratës së komercializimit dhe zhdukja e parave nga llogaria e NSH-së

### *C. Fantazmat e socializmit vetëdrejtues*

Më i rëndësishëm se administrimi direkt ndërkombëtar i NSH-ve ishte angazhimi i ri i DTI-së për Ligjin mbi Ndërmarrjet të vitit 1988. Ky ligj ishte një komponent kyç i socializmit vetëdrejtues jugosllav, një formë qeverisjeje e përbashkët e përpunuar nëpër dekada të tëra nga ideologjistët e Titos dhe nga aparaturat që e pasuan atë dhe më pas u braktis si i pa përdorshëm në vitin 1990 po nga ajo parti që e kishte krijuar atë. Një nga efektet paradoksale të përkushtimit të UNMIK-ut ndaj statutit të vitit 1989 si ligj i aplikueshëm ishte restaurimi apo kthimi i socializmit vetëdrejtues me të gjithë madhësitë – të paktën në letër.

Nën sistemin e vjetër jugosllav, kolektivi i punëtorëve ishte njësi kryesore e udhëheqjes vetëdrejtuese, në fakt konstituimi i vetë kompanisë.<sup>25</sup> Zgjidhej një këshill punëtorësh, në mënyrë tipike me një përbërje prej 10 deri 20 punëtorësh, të cilët formonin organin më të lartë ekzekutiv të ndërmarrjes dhe që ishte përgjegjës për emërimin e drejtuesve. Sipas ligjit të vitit 1988 përgjegjësitë e këshillit të punëtorëve ishin:

“të përcaktojnë organizimin e kompanisë shoqërore, aprovojë planin e punës si dhe planin për zhvillimin e kompanisë, përcaktojnë bazën për politikën e transaksioneve të biznesit, emërojnë dhe heqë nga zyra organet ekzekutuese, drejtuesë dhe drejtorë,

<sup>24</sup> Megjithatë nuk ekziston asnjë bazë e vetme të dhënash për këtë. Për 50 përqind të të gjitha ndërmarrjeve në listën e bazës së të dhënave të NSH-ve në DTI në qershor 2002, nuk ka asnjë informacion për mënyrën e qeverisjes së tyre.

<sup>25</sup> Kjo është ekzaktësisht e kundërta e marrëdhënieve perëndimore të punësimit, ku punëtorët individë i përfundojnë kontratat e punës me kompaninë si ent parësor ligjor.



kontrollojë dhe vlerësojë punën e tyre, vendosë mbi shpërndarjen e profitit dhe shqyrtojë propozimet e hedhura nga sindikatat në lidhje me ushtrimin e të drejtave vetëdrejtuese si dhe statusin material të punëtorëve, konkludojë marrëveshjet dhe kontratat vetëdrejtuese.”<sup>26</sup>

Në terma ideologjike ky sistem vetëdrejtues ishte pjesë e ‘vëshkjes apo venitjes së shtetit’ në favor të marrjes së drejtimit në mënyrë direkte nga ana e punëtorëve.

Nën këtë vetëdrejtim, punëtorët nuk ishin ‘pronarë’ të kompanisë – kapitali mbetej shoqëror. Megjithatë kolektivi i punëtorëve kishte marrë një përgjegjësi formale për drejtimin dhe ruajtjen e kapitalit shoqëror, i cili mund të përfshijë kapitalin financiar të investuar nga një fond zhvillimi ose bankë ose pasuri e patundshme e ndarë nga komuna. Kolektivi ishte i autorizuar të ‘përvetësonte të gjitha vlerat e shtuara’ të prodhuara nga kompania, pas interesave, taksave dhe zhvlerësimeve, por mbeti i nënshtruar ndaj kufizimeve të shumta të hartuara për të ruajtur vlerën e kapitalit. Në realitet, autoriteti i kolektivit ndaj vendimeve të biznesit ishte i kufizuar ndaj ndryshimeve marginale apo anësore të parëndësishme në ndarjen e të ‘ardhurave neto’ ndërmjet një numri fondesh: një fond kapital për riinvestim në ndërmarrje; konsumim kolektiv (mallra të blera për të mirën e kolektivit në tërësi, të tilla si pajisjet për pushime); rrogat dhe rezervat. Punëtorët nuk kishin asnjë autoritet për të shpërbërë pasuritë e kompanisë dhe as për ta përdorur kapitalin shoqëror për qëllime të tjera përveç atyre për të cilat është shpërndarë në fillim. Ky synim ishte përcaktuar në mënyrë strikte në statutet e kompanisë.

Si formë qeverisjeje e përbashkët, udhëheqja vetëdrejtuese e punëtorëve kishte disa kufizime të qarta, të analizuar gjerësisht si nga studiuesit apo komentatorët jugosllavë ashtu edhe nga të huajt gjatë viteve 1970 dhe 80.<sup>27</sup> Kolektivi i punëtorëve tregoi një tendencë të parashikueshme për të maksimizuar rrogat dhe përfitimet brenda kufijve të lejuar, për të mbrojtur anëtarësinë e tij ndaj shkarkimit, për t’i rezistuar zgjerimit të vetë kolektivit, për t’i rezistuar ristrukturimit të kompanisë, për t’i rezistuar iniciativave të reja të biznesit të cilat kërkojnë aftësi të cilat anëtarët ekzistues nuk i kishin dhe ndoshta më e rëndësishmja, për dekapitalizimin progresiv apo në rritje të vetë kompanisë.

Për këtë arsye Jugosllavia socialiste ka eksperimentuar në mënyrë konstante kontrollet institucionale të hartuara për të kufizuar lirinë e ndërmarrjeve vetëdrejtuese. Siç u përmend më sipër, NSH-të kishin linja direkte raportimi në komunë dhe përmes komunës në partinë komuniste. Kishte kufizime staturore ndaj autoritetit të kolektivit për rritjen e rrogave dhe shpërndarjen e të ardhurave. Kishte sisteme komplekse për planifikimin kontraktor përmes marrëveshjeve shoqërore dhe vetëdrejtuese, të cilat i mbyllnin NSH-të në synime prodhimi dhe strategji më të gjera sektoriale, diferenca të kufizuara në rroga ndërmjet firmave dhe qasje të përcaktuara ndaj kredive, monedhë të fortë dhe liçenca import/exporti.

Eshtë e panevojshme të thuhet që kontrollet komplekse institucionale të cilat e rrethonin udhëheqjen vetëdrejtuese të punëtorëve kanë zgjatur shumë derisa u zhdukën nga Kosova.

<sup>26</sup> Neni 49.

<sup>27</sup> Në mes të shpjegimeve të dhëna në anglisht janë: Harald Lydall, *Jugosllavia në krizë*, Clarendon, 1989; Christopher Prout, *Socilaizmi i tregut në Jugosllavi*, Oxford University Press, 1985; E.O. Furubotn dhe S. Pejovich, ‘Të Drejtat e Pronës dhe Sjellja e Firmës në një Shtet Socialist: Shembulli i Jugosllavisë, 30 *Zeitschrift fuer Nationaloekonomie*, 1970; Willem Burger, Gerard Kester dhe Guus den Ouden, *Vetëdrejtimi dhe Kontrollimi i Investimit në Jugosllavi*, Instituti i Studimeve Shoqërore, Hagë, 1977; B. Ward, ‘Firma në Iliri: Sindikalizmi i Tregut, *Shqyrtim Ekonomik Amerikan*, VII 48, shtator 1958.

Partia komuniste ka shkuar. UNMIK-u i ka ndaluar komunat të mbikqyrin NSH-të. Rregulloret që kontrollojnë shfrytëzimin e pronës shoqërore nuk monitorizohen, pa përmendur zbatimin e tyre. Si rezultat, për herë të parë në historinë e vetëdrejtimit, NSH-të janë të lira të përdorin kapitalin shoqëror në çdo mënyrë që e zgjedhin ata, duke i shpenzuar të ardhurat e tyre krejtësisht në rroga apo përfitime personale nga ana e drejtuesve të rinj.

Për këtë arsye orientimi i UNMIK-ut në ligjin socialist në vendin e punës së demokracisë ngriti më shumë pyetje sesa dha përgjigje. Një problem shumë themelor është: Kush është kolektivi i punonjësve? Në njërin anë Ligji mbi Ndërmarrjet i vitit 1988 dhe statutet e kompanisë vendosën në mënyrë të detajuar rregullat që qeverisnin përvetësimin si dhe humbjen e anëtarësimit në kolektiv. Në anën tjetër në teori NSH-të janë bërë subjekt i rregulloreve të UNMIK-ut në marrëdhëniet e punës,<sup>28</sup> që sjell atë që çdo punëtor duhet të ketë një kontratë pune individuale. Në praktikë asnjëri prej regjimeve ligjore nuk është duke u praktikuar tek NSH-të. Gjatë përgatitjeve për zgjedhjet e punëtorëve, UNMIK-u thjesht pranon listën e punëtorëve të paraqitur nga ata që momentalisht janë në kontroll të kompanisë.

Zgjedhjet pa rregulla të qarta si p.sh. kush ka të drejtë vote, janë krejtësisht të dështuara. Kushdo që kontrollon NSH-në mund të influencojë përbërjen e fuqisë punëtore duke zgjedhur nga grupi i punëtorëve të së kaluarës dhe të tashmes. Kjo i mundëson atyre të ndikojnë në rezultatin e zgjedhjeve të punëtorëve. Për këtë arsye nuk është çudi të zbulosh që në shumë raste zgjedhjet e fuqisë punëtore thjesht kanë legjitimizuar marrëdhëniet ekzistuese të pushtetit brenda NSH-së. Ky konfuzion ligjor ka gjithashtu implikime sociale të dallueshme. Diskriminon në mënyrë direkte punëtorët serbë dhe malazezë të cilët ikën nga Kosova në fund të luftës dhe gjithashtu diskriminon shumë shqiptarë të Kosovës sipas përkatësisë së tyre politike.

Një problem i dytë ka të bëjë me përgjegjshmërinë e drejtuesve. Vendimet më të rëndësishme mendohet të merren nga këshilli dhe jo nga drejtori dhe disa duhet të aprovohen nga i tërë kolektivi. Drejtorët mund të emërohen dhe hiqen shumë lehtë nga këshilli i punëtorëve, veçanërisht tani që mbikqyrja politike është hequr. Si rezultat, udhëheqja është relativisht e dobët dhe përgjegjësia është shumë e shpërndarë – një problem që i ka ndërlikuar gjithmonë ndërmarrjet jugosllave. Në fakt rënia e pushtetit të ‘teknokracisë’ – që është udhëheqja – ka qenë gjithmonë një nga qëllimet politike të vetëadministrimit.

Problemi i tretë është konsistenca. Ligji i vitit 1988 duket se operon vetëm kur është nevoja për të zgjidhur një mosmarrëveshje specifike dhe në rastet e tjera nuk është përfillur fare, madje edhe nga vetë DTI-ja. Pjesa më e madhe e NSH-ve nuk kanë mbajtur zgjedhje dhe akoma vazhdojnë të operojnë dhe të hyjnë në obligime detyruese. DTI-ja nuk ka krijuar ndonjë sistem monitorimi aty ku janë mbajtur zgjedhjet e këshillave të punëtorëve dhe nuk duket se i trajton ato si një detyrim ligjor të NSH-ve. Rezultati është një diversitet i gjerë arranjimesh të qeverisjes së përbashkët në NSH-të e Kosovës, duke përfshirë drejtorët e emëruar nga qeveria e UÇK-së e pasluftës ose nga komunat vendase, drejtorët para vitit 1989 të cilët janë kthyer në vendet e tyre të punës si dhe drejtorët e emëruar së fundmi nga një këshill i zgjedhur punëtorësh.

Kjo përpjekje disi me gjysëm zemër për të vendosur demokracinë në vend ka pasur dy pasoja të paqëllimta për politikën e sektorit të NSH-ve në të ardhmen. Njëra është se ka forcuar

<sup>28</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27 mbi Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, Neni 1.1: ‘Rregullorja ekzistuese rregullon punësimin në Kosovë, duke përfshirë marrëdhëniet e punës sipas të cilave është kryer puna ose shërbimet’.

elementet më konservative në secilën kompani, duke garantuar rezistencë në reformat e ardhshme. Provat mund të shihen në rezultatet e komercializimit e nënvizuara më poshtë. Të 12 marrëveshjet e suksesshme të koncesionit janë konkluduar me kompani ku nuk është mbajtur asnjë zgjedhje për këshillin e punëtorëve. Anasjelltas kurdoherë që një këshill punëtorësh ishte në vend, në mënyrë të paevitueshme lëvizte për të bllokuar konkluzionin e një marrëveshjeje koncesioni, duke mos pasur dëshirë të dorëzojë autoritetin e sapo marrë tek një investues i huaj. Rastet kur një këshill i zgjedhur punëtorësh e ka refuzuar qasjen e një investuesi të zgjedhur nga një komision tenderi përfshijnë FAN “Zahir Pajaziti” (Podujevë), Eurometal (Ferizaj), Morava e Binçes (Gjilan), Ramiz Sadiku (Prizren) si dhe Fermën e Troftës (Istog).

Ndikimi është rritja e shpresave të kolektivave të punëtorëve në lidhje me përfitimet që do të marrin ata eventualisht nga privatizimi. Në fillim të vitit, në një përpjekje për të marrë aprovimin e KB-së për privatizim, DTI-ja shkurtimisht argumentoi në lidhje me atë që NSH-të në një mënyrë ‘i takojnë’ punëtorëve dhe prandaj në asnjë mënyrë nuk ishin pronë e shtetit. Ky argument më vonë u zgjidh. Megjithatë vetëadministrimi jugosllav në anën e punëtorëve ka prodhuar gjithmonë një sens pronësie të fortë subjektiv. Fletëpagesat e tyre mujore tregonin një rrogë bruto të madhe, e ndjekur nga një listë e gjatë zbritjesh për taksat, detyrime të tjera dhe akordimeve të ndryshme brenda kompanisë. Si rezultat punëtorët filluan të besonin që fondet e tyre po përdorshin për të ndërtuar kompaninë. Në prag të një procesi të shumëpritur të privatizimit, rindërtimi i kolektivave të punëtorëve ka krijuar përshtypjen se punëtorët do të bëhen kapitenët e rinj të industrisë në Kosovë. Këto përshtypje eventualisht duhet të sheshohen. Kur të ndodhë kjo UNMIK-u mund ta gjejë veten në një konflikt me të gjitha strukturat të cilat ka munduar t’i restaurojë.

#### *D. Koncesionet e NSH-ve*

Sëbashku me zgjedhjet e këshillave të punëtorëve dhe administratën direkte, DTI-ja kishte një mënyrë të tretë veprimi në arsenalin e strategjive të veta ndaj NSH-ve. Për shkak të kundërshtimeve nga Zyra Ligjore e UN-it ndaj çdo skeme të hapur privatizimi, DTI-ja sëbashku me Departamentin e Administratës Vendase sajoi alternativën e dhënies me qera të NSH-ve për interesa private komerciale – një politikë e cila u bë e njohur si ‘komercializimi’.<sup>29</sup> Ishte menduar si një mjet për thithjen apo tërheqjen e kapitalit të ri në sektorin e NSH-ve dhe krijimin e vendeve të reja të punës, pa e trajtuar problemin kompleks të pronësisë së NSH-ve.<sup>30</sup>

Tiparet kryesore të strategjisë së komercializimit ishin si më poshtë. DTI-ja ofroi kontrata qeraje 10-vjeçare për një NSH të caktuar, përmes tenderit publik. Ofruesi fitues paguante një shifër vjetore koncesioni dhe bënte një sërë investimesh kapitale në kompani. Marrëveshjet e koncesionit përfshinin gjithashtu detyrimet për ta mbajtur fuqinë punëtore, investime në programe trajnuese si dhe ndarjen e profiteve në të ardhmen me punëtorët. Të ardhurat relativisht modeste nga marrëveshjet e koncesionit nuk u vendosën në Buxhetin e Konsoliduar

<sup>29</sup> Eksperienca me komercializimin është ekzaminuar më me detaje në një raport të mëvonshëm të LLA-ESI-së.

<sup>30</sup> “Koncesionet mund të jepen për një gamë të gjërë aktiviteteve ekonomike, duke përfshirë pa kufizime, aktivitetet e minierave dhe gurorëve; ndërtimi dhe operimi i ndërtesave, rrugëve, hekurudhave, ambjenteve të transportit ajror dhe ambjenteve të transporteve të tjera, ose linjave të gazit dhe naftës, pajisjeve dhe mjeteve; ambjenteve të telekomunikacionit dhe shërbimit publik; bujqësisë, ambjentet e sektorit të ujit dhe pajisjeve”: Udhëzime për Administrimin Financiar 1999/2, korrigjuar me datë 15 dhjetor 1999. Shiko gjithashtu Udhëzime për Administrimin Financiar Nr. 5/2000 mbi Koncesionet”, 5 korrik 2000.

të Kosovës, por në trust (kujdestari) për zgjidhjen e pretendimeve pronësore ndaj kompanisë në të ardhmen. Marrëveshjet e koncesionit i japin qiramarrësit të drejta favorizuese në çdo proces privatizimi në të ardhmen. Megjithatë, në rast se privatizimi nuk ndodh, qiramarrësi nuk ka të drejtë të rimarrë koston e investimeve të tij në kompani. Sipas rregullave të nxjerra nga Autoriteti Qendror Fiskal (AQF) në vitin 2000, ndërkohë që vlera e një NSH-je në një koncesion mund të mos ulet, çdo rritje në vlerë nuk duhet të krijojë detyrim për UNMIK-un që të paguajë për investimin.

Marrëveshja e koncesionit e konkluduar ndërmjet Fabrikës së Sharr Cement në Han të Elezit me datë 13 qershor 2000 ishte si komercializimi më domethënës ndër të gjitha komercializimet ashtu edhe më shpërthyesi në zhvillimin e vetë politikës. I ndodhur afër kufirit me Maqedoninë, Sharr Cement nisi të tërheqë interesin e investuesve të huaj menjëherë me vendosjen e misionit të UNMIK-ut. Në nëntor të vitit 1999, shefi i Shtyllës së BE-së Joly Dixon hetoi mbi mundësinë e dhënies “në koncesion ose me qera tek një prodhues i njohur i çimentos, i cili do të ndërmerre investime në drejtim të zhvillimit afatgjatë të fabrikës si dhe hapa drejt rigjallërimit në të ardhmen e afërt”.

Fabrika e Sharr Cement është një rast jo karakteristik në shumë mënyra. Rënia e murit të Berlinit shpërtheu një garë shumë konkurente ndërmjet industrisë globale për blerjen e fabrikave të çimentos në të gjithë Evropën Qendrore dhe Lindore. Sipas burimeve të industrisë,<sup>31</sup> prospektet më të mira gjindeshin në Evropën Juglindore, ku fabrikat e çimentos po kërkoheshin me shpejtësi nga shoqëritë e mëdha evropiane perëndimore të tilla si Lafarge (Francë), Heracles (Greqi), Holderbank (Zvicër) dhe Heidelberger (Gjermani). Prandaj nuk është çudi që 21 kompani nga e gjithë bota ishin të interesuara për Sharrin.

**Tabela 2: Pasqyra e marrëveshjeve të koncesionit**

	Data e nënshkrimit	Sektori	Ofertat për tender	Investuesi
Sharr Cement	13-jan-00	Ndërtim	9	Holderbank AG.
Mirushë	6-dhjet-00	Ndërtim	2	SACET/SNAAB
Mishi Progress	2-mar-01	Përpunim bujqësor	1	Fructus
Eksport Progress	19-prill-01	Përpunim bujqësor	3	Abi Elif-19
Fapol	2-korrik-01	Ndërtim	1	CRK Konsortium
Mustafa Goga	9-nënt-01	Ndërtim	1	KMPN Tullorja
Alcon Luledielli	8-gusht-01	Përpunim bujqësor	1	Alcon Sh.p.k.
Betonjerka	25-jan-01	Ndërtim	1	2K-Group
Adi Poultry	2-korrik-01	Përpunim bujqësor	1	ADI
Artizanati	5-tetor-01	Tekstil	1	Astra-B
Kosova Tulla	1-nënt-01	Ndërtim	3	Italkosova
Termovent	29-nënt-01	Ventilatorët	1	Dajti Sh.p.k.
Minex	5-shkurt-02	Përpunim bujqësor	1	Neraimpex

<sup>31</sup> Jim Catterson, ‘Industria e çimentos – Pasqyrë ndërkombëtare, maj 2001.

Ofruesi fitues, shoqëria gjigande Holderbank nga Zvicra e njëjtte mirë tregun ballkanik, pasi kishin blerë fabrika çimentoje në Hungari, Kroaci, Rumani dhe Bullgari. Holderbank ka nën pronësi aksione në fabrikën e çimentos në Usje në Maqedoni (konkurenti më i afërt i Sharrit) dhe së fundi ka fituar një nga tre fabrikat e çimentos në Serbi, e cila ndodhet në Novi Popovac, ku ka bërë një investim total prej mbi 150 milion € për të marrë 70 përqind të kompanisë. Për koncesionin dhjetë-vjeçar në Sharr, Holderbank ka rënë dakort të paguajë një qera vjetore prej të paktën 500,000 € për të bërë investime të mëtejshme prej rreth 30 milion € dhe për të investuar 20 përqind të përfitimeve vjetore në një fond për punëtorët. Kjo ishte një marrëveshje tërheqëse në tregun aktiv të çimentos.

Sipas projekteve të përgatitura nga ekspertë të pavarur, Holderbank premton ta kthejë një pjesë të mirë të profitit në investime në Sharr, me kapacitetin e saj për të prodhuar deri në gjysëm milioni ton çimento çdo vit.<sup>32</sup> Në anën tjetër në luftën e ashpër për të dominuar në tregjet evropiane të çimentos, Holderbank mundet gjithashtu ta konsiderojë investimin e saj të justifikuar edhe nëse Sharr nuk prodhon asnjë gjë. Shkurtimisht ky ishte një investim me logjikën e vet të veçantë, e cila nuk kishte të ngjarë të zëvendësohej me një NSH tjetër kosovare.

Që atëherë DTI-ja ka konkluduar dymbëdhjetë kontrata komercializimi. Duke e riparë situatën, tre prej tyre janë krejtësisht dështime kurse pesë duken se janë të suksesshme. Në dy raste, të dyja fabrika tullash, investimi është bërë kohët e fundit dhe është herët për ta vlerësuar. Dy të tjera i takojnë një kategorie të veçantë e cila meriton ekzaminim të veçantë – më shumë si transaksione të komplikuar të pasurive të patundshme sesa marrëveshje koncesioni.

Dy nga tre dështimet janë gjithashtu në industrinë e betonit, një treg që varet shumë në projektet në shkallë të madhe të infrastrukturës publike. Mirusha në komunën e Klinës në Kosovën perëndimore ishte kompania e parë që u komercializua nga DTI-ja e sapokrijuar dhe gjithashtu e para kontratë që u anulua. Pasi nuk arriti t'i paguajë punëtorët për më shumë se gjashtë muaj, investuesi italian u tërhoq në muajin prill 2002, duke ia lënë në dorë UNMIK-ut emërimin e një drejtuesi të përkohshëm dhe konsiderimin e një mundësie për ndërmarrjen e veprimeve ligjore për shkeljen e kontratës. Betonjerka, një kompani në Mitrovicë e cila prodhon produkte të ndryshme betoni, ka mbetur pa punë që nga komercializimi i saj në qershor të vitit 2001. Ka punësuar shtatë roje sigurimi, po nuk ka pasur asnjë shenjë të ndonjë investimi tjetër. Të dyja kompanitë ndodhen në shtratet e lumit me shumë rezerva zhavori dhe rëre – burime që kanë kërkesa gjatë periudhave kur ndërtimet arrijnë kulmin. Megjithatë nuk ka pasur asnjë interes të dukshëm për përdorimin e këtyre kompanive në industrinë përpunuese. Rasti i tretë i pasuksesshëm, Artizanati është një qendër e punimeve me dorë në Prizren e cila i është dhënë me qera një kompanie private që ka lidhje me ish-drejtorin e saj. Procesi i komercializimit ka përfunduar në zënka ndërmjet punëtorëve dhe investuesit dhe mbetet të shihet nëse kompromisi i fundit i ndërmjetësuar në qershor 2002 nga ana e DTI-së do të rezistojë.

---

<sup>32</sup> Këshilluesit nga CemPro shkruan: “në rast se shitjet mund të rriten, fabrika do të jetë një investim mjaft i mirë. Unë pres që të gjithë prodhuesit kryesorë të çimentos në Evropë të paraqesin oferta për dhënie me qera të planeve, plus disa nga instrumentet e tjera... Mungesat më të mëdha të fabrikës janë të një natyre relativisht më të vogël, p.sh. kryesisht çështje pjesësh rezervë dhe instrumentesh.” Analiza e fabrikës nga CemPro, 18 shkurt 2000.

Pesë rastet e suksesshme të komercializimit të gjitha ndjekin një tipar të qartë. Ato janë të gjitha ndërmarrje të përpunimit bujqësor dhe ish-njësi prodhuese të gjigandit *agro-kombinati* Agrokosova. Secila prodhon produkte në tregun e hapur me etiketën e saj. Rreçeli dhe perimet e konservuara nga Abi-Elif-19, suxhuku nga Fructus, vezët nga Adi, vaji i lulediellit në shishe nga Alcon dhe gjevreku nga Nerakondi sot mund të gjenden në pjesën më të madhe të supermarketeve në Kosovë.

Të gjitha këto kompani vazhduan të punojnë gjatë viteve 90 nën udhëheqjen serbe dhe e kaluan luftën pa dëme të mëdha, duke u mundësuar atyre rifillimin e prodhimit menjëherë në vitin 2000, megjithëse me kapacitet të reduktuar.<sup>33</sup> Duke pasur produktet më të shitura të sektorit bujqësor të Kosovës, ato kontrollojnë pasuri unike dhe gëzojnë pozicione dominuese në tregun vendas. Progress-Export ka të vetmin frigorifer me kapacitet të plotë prej 5,000 ton, së bashku me një monopol në frutat dhe perimet e përpunuara dhe një markë gjerësisht të njohur nga konsumatorët kosovarë. Alcon është i vetmi prodhues i vajit të lulediellit, me mjete të reja për prodhim të cilat datojnë vetëm përpara luftës. Fructus ka të vetmen thertore aktive në shkallë industriale në Kosovë dhe është e vetmja që ka marrë ndonjëherë një certifikatë shëndeti dhe higjienë nga Bashkimi Evropian.

Në mënyrë interesante ekziston një model i qartë në mesin e investuesve në këto kompani. Të pestë ishin kompani kosovare të cilat kanë qenë në tregun me shumicë dhe pakicë gjatë viteve 1990, në disa raste duke gëzuar marrëdhënie të ngushta tregtare me ndërmarrjet që më vonë i morën me qera. ADI ka operuar në katër magazina dhe një zinxhir të mallrave me pakicë në Lipjan, duke mbajtur kontrata furnizimi me shumë nga NSH-të kryesore në Kosovë. Neraimpex merrej me shitjet ushqimore me pakicë dhe shumicë në Ferizaj, Kaçanik, Viti dhe Shtime, me të ardhura mujore prej 1 milion € në vitin 1997-8. ABI në fillim ka qenë prodhues i produkteve të djathrave, duke u zgjeruar në vitet 1990 në supermarkete brenda dhe jashtë Prizrenit. Qiradhënësit e Fructusit drejtonin një rrjet prej më shumë se 500 dyqanesh të veçanta në të gjithë Kosovën në fillimet e vitit 1990, me të ardhura të kombinuara deri në 15,000 € në ditë.

Këta investues shkonin shumë mirë me fabrikat e përpunimit bujqësor që fituan, duke sjellë si ekspertizën e marketingut ashtu edhe një rrjet shpërndarës të përforcuar. Ata ishin mjaft të njohur me NSH-të, produktet e tyre si dhe me pozicionin e tyre në treg. Si rezultat i aktiviteteve të tyre tregtare në vitet 1990, ata kishin para në dorë për të investuar. Veçanërisht në atë kohë nuk kishte pothuajse asnjë investues tjetër në një pozicion të atillë për të shfrytëzuar këto mundësi tregtare. Nga pesë rastet e suksesshme të komercializimit, katër prej tyre ishin tërheqëse vetëm për një ofrues të vetëm.

Duke i lënë mënjanë dy fabrikat e tullave, të cilat nuk mund të vlerësohen akoma, dy rastet e mbetura mund të quhen 'komercializime të pasurive të patundshme'. FAPOL-i ishte një prodhues i kullave poliestër në Podujevë. Investuesi, një biznesmen vendas e bëri të qartë që në fillim se ai nuk kishte asnjë qëllim për ta filluar këtë aktivitet tregtar. Ai ishte i interesuar në tokën e FAPOL-it të cilën si ofrues i vetëm ai e mori për një tarifë mujore koncesioni prej 750 € për diku 7 hektarë. Duke e marrë parasysh detyrimin e tij për të paguar 85 punëtorë me rroga nga 175 € në muaj, qeraja efektive e tij ishte 0.23 € për m<sup>2</sup>, përafërsisht çereku i çmimit të tregut për këtë tokë. Me një vendndodhje afër vijës kufitare administrative me Serbinë, ai ka investuar 1.2 milion € për ndërtimin e një stacioni të ri doganor. Ai gjithashtu ka krijuar një linjë grumbullimi për vaskat e importuara nga Turqia.

<sup>33</sup> Ferma e shpendëve ishte i vetmi aktivitet tregtar që nuk filloi prodhimin deri pas komercializimit.

Rast i ngjashëm ka qenë Termoventi në Lipjan. Investuesi nuk ka asnjë qëllim që të fillojë biznesin qendror të ventilatorëve. Në të vërtetë në një ndërmarrje të përbashkët me një partner italian ai ka filluar të zhvillojë një fabrikë për prodhimin e pjesëve të polietilenit për mobilje, të destinuar për eksport në Itali. Në të dyja rastet investuesi e pranon hapur që detyrimet totale financiare sipas marrëveshjes së koncesionit – tarifa vjetore plus rogat e punëtorëve – u përputhën me çmimin e mirë për marrjen e një cope të mirë toke. Të dy investuesit do të preferonin ta kishin blerë tokën menjëherë, sikur t'u ishte dhënë mundësia.

Në një total prej më shumë se 330 NSH në atë kohë të njohura për DTI-të, vetëm 65 u nxorrën në tenderin për komercializim nga fundi i vitit 2001. Interesi i investuesi ishte përgjithësisht i ulët: vetëm 34 tenderë tërhoqën një ofertë të besueshme; prej tyre, vetëm 7 tërhoqën më shumë se një ofertë. Në fund u konkluduan të 12 marrëveshjet e koncesionit, më e fundit (Minex) në shkurt të vitit 2002. Që atëherë, edhe pse DTI-ja ka vazhduar të publikojë tenderë, nga UNMIK-u nuk është nënshkruar asnjë marrëveshje tjetër koncesioni dhe ajo politike tashmë duket të jetë braktisur.

Modelet e dala nga procesi i komercializimit sugjerojnë shumë qartë një numër mësimesh të rëndësishme për përpjekjet e ardhshme të privatizimit. Së pari ka pasur disa suksese në dhënien me qera të NSH-ve si çështje në vazhdim. Megjithatë këto suksese janë varur nga rrethana mjaft të veçanta të cilat mungojnë në pjesën më të madhe të NSH-ve në Kosovë. Arritja e këtyre gjashtë rasteve të suksesshme (nëse përfshijmë Sharr Cementin) tërhoqi shumë burime ndërkombëtare, duke përfshirë përgatitjen e 65 kompanive për tender. Sektorët kryesorë të cilët tërhoqën oferta serioze ishin sektorët e përpunimit bujqësor dhe ndërtimit. Rastet e suksesshme ishin të gjitha kompanitë të cilat kanë pasur prodhim të suksesshëm në kohën e tenderit, ose kanë qenë gati të fillojnë prodhimin menjëherë. Ata ishin të gjithë në një pozicion për të pasur monopolin ose për të pasur një pozicion dominues në tregun kosovar dhe si rrjedhojë për të pasur një profit të shpejtë për investuesin. Të gjithë investuesit e suksesshëm bënë biznes me kompani të cilat kishin punuar në sektorët e ushqimit dhe/ose ndërtimit gjatë viteve 1990 dhe që i kishin krijuar mjaft mirë rrjetet e shpërndarjes.

Ajo që nënkuptohet është se kur këto kushte që u nënvizuan janë të pranishme, NSH-të mund të jenë tërheqëse për investuesit seriozë. Megjithatë pjesa dërrmuese e NSH-ve nuk i plotëson këto kushte dhe nuk kanë asnjë vlerë për një biznes në zhvillim e sipër.

Dy 'komercializimet e pasurive të patundshme' të Fapolit dhe Termoventit ofrojnë një mësim të ndryshëm. Duke folur në përgjithësi edhe NSH-të më të vjetra kanë pasuri të vlefshme, kryesisht ndërtesa dhe tokë infrastrukture. Kërkesa e lartë nga sektori privat për prona tregtare të vjetëruara ka çuar në një treg tejte të nxehtë të pronës, duke i kthyer shumë nga NSH-të në biznese me qera. Vlerësimi i këtyre jashtë sektorit të NSH-ve dhe vendosja e tyre në qarkullim në tregun e hapur është qartësisht një element kyç për politikën ekonomike.

Çështja është nëse dhënia me qera apo shitja e NSH-ve për aktivitetet në vazhdim është strategjia e përshtatshme për arritjen e këtij objekti. Në të dyja rastet e ekzaminuara më sipër investuesit kanë qenë të detyruar të ndjekin një procedurë koncesioni të përpunuar në mënyrë që të përfitohet një pjesë interesante pasurie e patundshme. Në vend të blerjes së tokës menjëherë, ata ndërmorrën një detyrim 10-vjeçar ndaj kompanisë dhe punëtorëve të saj. Si ofrues të vetëm, ata ishin në gjendje ta merrnin kompaninë të tërën më lirë sesa ç'ishte çmimi i tregut vetëm për tokën. Në fakt, UNMIK-u e ka dhënë me qera tokën me zbritje mjaft të volitshme për të mbuluar detyrimet e lidhura me marrjen e përgjegjësisë për NSH-në.

Pyetja është: A është kjo një metodë rracionale për nxjerrjen e pasurive të NSH-së në tregun e hapur?

Mësimi i katërt i komercializimit ka të bëjë me kufizimet e autoritetit ndërkombëtar. Asnjë marrëveshje e vetme koncesioni nuk është konkluduar në sytë e palës kundërshtare si të punëtorëve ashtu dhe të komunës. Në Gjilan dhe Pejë, komunat e kundërshtuan haptazi dhe në mënyrë të suksesshme të gjithë politikën e komercializimit, duke bërë thirrje për ta ndaluar 'këtë tendencë të papranueshme centralizimi dhe diktature të çmendur nga ana e nivelit qendror'.<sup>34</sup> Kudo që të ekzistonte një këshill i zgjedhur punëtorësh, negociatat apo bisedimet për dhënien me qera të kompanisë ishin të zgjatura dhe krejtësisht të pasuksesshme, pasi ishte e dukshme që punëtorët nuk ishin të gatshëm për t'ia lënë kontrollin e kompanisë një investuesi të jashtëm. Eksperienca tregoi se UNMIK-u kishte pak kapacitet për të sjellë ndryshime në sektorin e NSH-ve në sytë e një opozite të përbashkët.

Një pikë e fundit që ia vlen për t'u përmendur rreth komercializimit është se 'shteti' i Kosovës, në formën e UNMIK-ut, ka treguar pak interes për t'u siguruar që investuesit të përmbushin detyrimet e tyre financiare sipas marrëveshjeve të koncesionit. Në qershor 2002, të 12 koncesionet kishin sjellë 137,779 € në tarifa vjetore dhe depozita tenderësh, të mbajtura të llogaritë e caktuara në administruara nga Autoriteti Qendror Fiskal si dhe nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave.<sup>35</sup> Sipas kontratave, rreth 1,800,000 €<sup>36</sup> duhet të ishin paguar në fillim të qershorit të këtij viti, me anulimin e koncesioneve.<sup>37</sup> Mungesa e interesit në mbledhjen e këtyre të ardhurave mund të jetë e lidhur me faktin që paratë nuk janë të destinuar për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës. Përveç nëse institucionet publike të Kosovës kanë një interes imponues për ta shtyrë përpara procesin e komercializimit, detyrimet e shtjelluara të dhëna në marrëveshjet e koncesionit do të kenë pak vlerë.

#### **IV. DILEMA OTOMANE**

Po qartësohet një vlerësim i një politike tre-vjeçare ndërkombëtare ndaj NSH-ve:

⚡ Nga fundi i vitit 2000, administratorët komunalë të UNMIK-u në disa pjesë arritën të krijojnë një shkallë të kufizuar mbikqyrjeje ndaj NSH-ve të caktuara në zonat për të cilat ata ishin përgjegjës. Ky mekanizëm kontrollues si pasojë u hoq.

⚡ Praktika e DTI-së për vënien e drejtuesve të përkohshëm ndërkombëtarë nuk u përmblodh kurrë në diçka më tepër sesa një masë e përkohshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, përpara rikthimit të NSH-ve nën kontrollin e atyre që janë të brëndshëm.

<sup>34</sup> Letër nga Presidenti i Komunës së Gjilanit, 19 prill 2001

<sup>35</sup> Me rekomandimin e sektorit financiar të DTI-së, ky numër është marrë direkt nga deklaratat origjinale bankare të mbajtura nga Njësia e Administrimit të Parave të AQF-së si dhe Autoriteti Bankar dhe i Pagesave. Me datë 11 qershor 2002, shumat totale të parave të mbajtura të llogaritë të caktuara për pagesat e koncesionit, tarifave të administrimit të tenderëve dhe depozitave të ofertave në Gjermani dhe Kosovë ishte 137,779 €. Në kontrast të kësaj sipas faturave të paraqitura nga investuesit, 1,260,662 € tashmë është paguar në llogaritë e DTI-së (duke përfshirë faturat për pagesën e faturave të KEK-ut, depozitat e rikthyeshme të tenderëve si dhe përgjegjësi të tjera të kaluara).

<sup>36</sup> Në pagesat e koncesionit ose pagesa e përgjegjësisë të kaluara siç është përcaktuar në kontrata.

<sup>37</sup> Sipas kontratave të komercializimit tarifave të koncesionit mbahen në llogari bankare të mbikqyrura nga DTI-ja, jo AQF-ja, në emër të kreditorëve të mundshëm në të ardhmen. Kjo është në kundërshtim me Udhëzimet Administrative të Financave 5/2000 të nxjerra nga Autoriteti Qendror Fiskal, e cila argumenton se koncesionet dhe marrëveshjet e qerasë "kanë për qëllim të sjellin të ardhura për të mirën publike të Kosovës. Të tilla të ardhura depozitohen në Fondin e Konsoliduar të Kosovës".



- €# Riprezantimi i vetëadministrimit të punëtorëve sipas Ligjit të Ndërmarrjeve të vitit 1988 zbatoi marrëdhëniet ekzistuese të pushtetit brenda NSH-ve, ndërkohë duke rikrijuar në mënyrë të pjesshme një formë të qeverisjes së përbashkët e cila ishte krejtësisht jo funksionale të Jugosllavinë e vjetër.
- €# Më në fund politika e komercializimit thithi pjesën më të madhe të burimeve ndërkombëtare në këtë sektor për rreth dy vite, por solli përfitime për jo më shumë se 6 nga 339 NSH-të e Kosovës. Duke e lënë mënjanë rastin e Sharr Cement, ka prodhuar një masë të kufizuar kapitali të ri investues, asnjë të ardhur për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës, shumë pak vende pune dhe vetëm ristrukturime modeste të ndërmarrjeve.

Përtej kufirit, politika e UNMIK-ut ndaj NSH-ve ka qenë një nga pranimet më qejfprishëse të *status quo* përse i përket fuqisë ekonomike dhe kontrollit. Ky *status quo* ekzistonte kur marrëdhëniet e pronës janë të varura nga marrëdhëniet e kompetencave dhe për këtë arsye ndryshojnë nga komuna në komunë dhe nga një ndërmarrje tek tjetra.

Problemet e UNMIK-ut i ngjajnë dilemës me të cilën u përballën sundimtarët otomanë në provincat ballkanike kur 150 vjet më përpara ata u përpoqën të prezantojnë një kod të ri për tokën. Gjatë mesit të shekullit të 19, perandoria parashikoi të reformonte strukturat e saj ekonomike duke prezantuar të drejtat individuale mbi pronën. Një dekret reforme i vitit 1839 lidhi sigurinë e titullit me përdorimin më produktiv të tokës, i cili konsiderohej esencial për mirëqënien ekonomike të perandorisë. Kodi otoman i tokës i vitit 1858 krijoi tituj të qartë për tokën si bazë për praktikën uniformë burokratike në të gjithë perandorinë. Ky ishte një kuptim i ri, revolucionar i pushtetit të shtetit, të inspiruar në pjesë të madhe nga nevoja për të mbajtur ritmin me zhvillimet kontemporane në Evropën perëndimore. Pushteti qeveritar përdorej për të dhënë siguri në transaksionet pronësore. Në anën tjetër, duke i pasur të gjitha pasuritë e përcaktuara qartë me ligj për një individ të veçantë apo person ligjor, qeveria do të ketë mundësinë të masë dhe regjistrojë mirëqënien e perandorisë dhe kështu ta taksojë atë në mënyrë të efektshme.<sup>38</sup>

Ky model i përkryer i shtetit modern pati konflikt me realitetin shoqëror të Ballkanit otoman. Të drejtat e pronës ishin përcaktuar sipas praktikave të zakonshme dhe thellësisht në ngulitura në marrëdhëniet vendase të kompetencave, të modifikuara aty këtu me anë të dekreteve individuale dhe urdhëresave (*irades*) të nxjerra nga sundimtarët otomanë në përgjigje të mosmarrëveshjeve të lokalizuara. Ishte një sistem ku sundimtari përdori të drejtën e tij të posatshme absolute për të shpërndarë toka dhe të ardhura ndërmjet grupeve të ndryshme sociale për të konsoliduar pushtetin e tij. Logjika e sistemit nuk ishte efektshmëria ekonomike por stabiliteti shoqëror. Kur perandoria tentoi ta reformojë këtë sistem nga sipër, rezultati ishte mosmarrëveshje të hidhura në lidhje me të drejtat pronësore ndërmjet grupeve të ndryshme në territoret e saj, nga Shqipëria në Bosnjë. Rreth vitit 1875, Xhevdet Pasha, një nga njerëzit kryesorë të reformave, shkruajti që në rast se kodi zbatohet në letër në provincat e Ballkanit, popullsia do të rrëmbente armët. Shkurtimisht, uniformiteti krijues i rregullave mbi pronën – themelimi esencial i ekonomisë moderne të tregut të lirë – nuk ishte asgjë më pak se revolucionare.

<sup>38</sup> Për një shpjegim në lidhje me këtë proces në mesin e shekullit 19 gjatë sundimit të perandorisë osmane në Ballkan, shiko Roger Owen (ed.), *Prespektivat e reja mbi Tokën dhe Pronën në Lindjen e Mesme*, Harvard Middle Eastern Monographs, Cambridge, 2000, në veçanti Huri Islamoglu, 'Prona si sferë e kontestueshme: një rivlerësim i Kodit Otoman për Tokën i vitit 1858'.

Eksperienca e tre viteve të fundit në Kosovë ka treguar vështirësinë e kombinimit të një interesi thelbësor për stabilitet ('ruajtja e paqes') me sfidën për të ndërtuar institucione të reja qeveritare dhe për të përgatitur bazat për zhvillim ekonomik. Si paraardhësit e tij otomanë, UNMIK-u është i paralizuar nga një mungesë e madhe e informacionit të besueshëm rreth realitetit në terren, nga burimet e kufizuara administrative të veta dhe vështirësia për t'i përballuar ata me interesa të pakundërshtueshme në *status quo*. Nuk ka pasur asnjë kapacitet për të përkthyer mandatin e tij të përgjithshëm si administrues i besueshëm i pronës shoqërore në mbikqyrje efektive ose administrim të 370 NSH-ve. Për këtë arsye e ka kufizuar rolin e tij për ruajtjen e paqes sociale duke ndërhyrë vetëm kur i paraqitej ndonjë mosmarrëveshje. Rezultati i kësaj është një seri zgjidhjesh *ad-hoc*, të lokalizuara, të cilat nuk nënkuptojnë një sistem koherent apo konsistent të të drejtave pronësore.

Megjithatë ajo çfarë po bëhet dita ditës më e qartë është se kjo qasje ka filluar të rrezikojë qëllimet kryesore të misionit ndërkombëtar në Kosovë. Në vend që të sigurohet paqe sociale, mungesa e egzistencës së shtetit ligjor në fushën e pronës ekonomike po çon në luftra të hidhura për kontrollin e NSH-ve dhe pasurive të tyre më të vlefshme, me pasoja sociale me rrezik të mundshëm. Për më tepër mungesa e një sistemi konsistent për të drejtat e pronës po vepron si një shtrëngesë serioze në zhvillimin e ekonomisë kosovare, duke krijuar një barrierë në hyrjen në treg dhe një mosbesim ndaj investimit në biznes. Në periudhën që po vjen, me rënien e mbështetjes direkte buxhetore ndërkombëtare, sektori privat i Kosovës duhet të mbajë barrën e konsiderueshme për financimin e zhvillimit të institucioneve të reja publike përmes krijimit të një regjimi taksor të efektshëm. Nuk duhet t'i kërkohet të mbajë koston e subvencionimit të mbeturinave të industrive socialiste.

## **V. DREJT KRIJIMIT TE PRONES NE KOSOVE**

Në fillim të viteve 2002 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm në Kosovë, Michael Steiner, shpalli tre prioritetet kryesore të UNMIK-ut: krijimi i vendeve të punës; krijimi i shtetit ligjor; dhe krijimi i një shoqërie të drejtë dhe të sigurtë në të cilën kthimet bëhen të mundshme. Dy nga këto objektiva nuk mund të arrihen pa marrë parasysh regjimin anarkik të pronës në Kosovë si dhe vakumin apo boshllëkun ligjor në të cilin operojnë tani ndërmarrjet shoqërore të saj. Vetë Steiner tha në një fjalim të tij në Universitetin e Prishtinës në prill të vitit 2002: "synimi më urgjent është qartësimi i pronësisë. E drejta e qartë ligjore është baza si për zhvillimin ekonomik ashtu edhe për ekzistencën e shtetit ligjor".<sup>39</sup>

Për momentin siç është reflektuar dhe në Rregulloren e AKM-së, strategjia e UNMIK-ut parashikon tre qasje drejt NSH-ve:

- ⌘ Privatizimi i atyre që premtojnë më shumë;
- ⌘ Likuidimi i atyre që premtojnë më pak;
- ⌘ Vazhdimi i kompetencave për administrimin e NSH-ve në pritje të privatizimit ose likuidimit.

Në lidhje me privatizimin, eksperienca na tregon se materiali me të cilin i duhet AKM-së të punojë nuk është shumë premtues. Ndoshta nuk ka më shumë se një grusht apo një sasi të vogël NSH-sh të cilat janë tërheqëse për një investues në formën e tyre të tanishme. Të tjerat

<sup>39</sup> Michael Steiner, fjalimi në Universitetin e Prishtinës, 18 prill 2002.

mund të bëhen tërheqëse duke marrë divizione premtuese të NSH-ve më të mëdha dhe duke ndërmarrë procesin e ashtuquajtur ‘spin-off’, siç është parashikuar në Rregulloren e AKM-së. Të tilla raste do të konsumojnë një sasi të konsiderueshme të burimeve ndërkombëtare.

Disa nga zhvillimet gjatë dy viteve të kaluara janë kundër AKM-së. Në veçanti restaurimi i vetëadministrimit të punëtorëve do të thotë se punëtorët do të kërkojnë një rol aktiv në procesin vendimmarrës të privatizimit. Megjithëse AKM-ja në letër e ka të gjithë autoritetin për të proceduar pa pëlqimin e tyre, pushteti i saj efektiv ndaj NSH-ve nuk do të jetë më i madh se i DTI-së. Asnjë investues legjitim nuk do të rrezikonte t’i hynte mosmarrëveshjeve me punëtorët në lidhje me kontrollin fizik të pasurive. Ashtu si me komercializimin, AKM-ja mund të ketë pak zgjedhje përveçse për të proceduar në hapësirën që e lejojnë vetë NSH-të. Pasi janë thënë të gjitha, do të quhej një sukses i konsiderueshëm në rast se AKM-ja arrin të privatizojë më shumë se 5 përqind të NSH-ve të Kosovës brenda dy viteve të ardhshme.

Rregullorja e AKM-së gjithashtu parashikon falimentimin e NSH-ve, me përdorimin e autoritetit të AKM-së për marrjen e vendimeve në emër të NSH-ve për t’i vendosur ato në ‘likuidim me dëshirë’. Likuidimi gjithashtu ka të ngjarë të hasë në rezistencë të fortë nga brenda NSH-së dhe do të kërkojë përpjekje të konsiderueshme nga ana ndërkombëtare. Duke pasur parasysh burimet e kufizuara në dispozicion të AKM-së dhe prioritetin që do t’i jepet privatizimit të NSH-ve që premtojnë, ekziston rreziku që likuidimi të procedojë edhe më me ngadalë se privatizimi, nëse do të ndodhë.

Për sa i përket drejtimit të përkohshëm të NSH-ve, kompetencat e AKM-së në letër janë virtualisht të pakufizuara. Mund të instalojë borde të reja dhe drejtues, madje edhe ta konvertojë apo shndërrojë NSH-në në kompani aksionere në pronësi të vetë AKM-së, duke e shpërbërë kolektivin e punëtorëve në mënyrë të efektshme. Megjithatë dyshohet nëse do të mund t’i zotërojë kompetencat e saj në mënyrë të efektshme në sytë e ndonjë opozite të përbashkët nga brenda vetë NSH-së. Si DTI-ja përpara saj, ajo ka të ngjarë që t’i përdorë kompetencat e saj ndërhyrëse vetëm në rastet kur është e nevojshme për të parandaluar zmadhimin e ndonjë mosmarrëveshjeje të caktuar. Nuk ka të ngjarë që të ndërmarrë detyrën e mundimshme për vënien e rregullit në qeverisjen e përbashkët të NSH-ve ose për të zbuluar dhe parandaluar keqpërdorimin e pasurive.

Për ta përmbledhur, duke pasur parasysh burimet e parashikuara për AKM-në, strategjia aktuale e UNMIK-ut ka mundësi të arrijë një numër privatizimesh të suksesshme dhe ndoshta disa likuidime. Por pjesës më të madhe të NSH-ve do t’i duhet të luftojë me situatën ekzistuese. Shkurtimisht, për momentin UNMIK-u nuk ka asnjë strategji për t’u marrë me kaosin e pronës të përshtuar në këtë dokument.

Ajo çfarë nevojitet është një strategji krijuese për pronën e cila aplikohet ndaj NSH-ve menjëherë, deri atëherë kur ato të jenë gati për privatizim apo likuidim. Kjo strategji duhet të trajtojë dy problemet më serioze, për momentin më të dukshmet në Kosovë:

- ¶ Faktin që rregullat drejtuese të pronës shoqërore si dhe rrjedhat e të ardhurave që vijnë nga prona shoqërore nuk janë të vendosura sipas ligjeve të përgjithshme, por ndryshojnë nga një vend në tjetrin në varësi të strukturave të pushtetit vendas dhe shkallëve të ndryshme të përfshirjes së UNMIK-ut;

- €# Faktin që grupi i vogël i individëve që momentalisht kontrollojnë NSH-të janë në gjendje të marrin të ardhura që nuk i kanë fituar nga përdorimi i pasurive, por nga aktivitetet e paligjshme qiramarrëse apo dhënëse, e cila mund të konsiderohet si taksë feudale e ditëve moderne në sektorin privat.

Strategjia që synon të ndryshojë *statusin quo*, në sy të opozitës nga grupet e vogla por me influencë që përfitojnë nga ajo, duhet të plotësojë disa kushte. Do të kërkojë mbledhjen sistematike të informacionit të detajuar nga institucionet publike të Kosovës (si nga agjencitë e UNMIK-ut ashtu edhe nga institucionet e përkohshme) për NSH-të dhe pasuritë e tyre, të ardhurat dhe aktivitetet. Dohet të komunikohen në mënyrë të efektshme në sektorë të ndryshëm të shoqërisë kosovare në mënyrë që të ndërtohet një koalicion më i gjerë në favor të ndryshimit të *statusit quo*. UNMIK-u duhet të sigurojë që burimet adekuate administrative të jenë në vend për një fushatë të mbështetur. Këto tre parakushte – qasja në informacion, ndërtimi i koalicionit dhe zbatimi i efektshëm – janë të lidhura ngushtë. Pa informacion real është e pamundur të komunikohet në mënyrë të efektshme; ndërtimi i koalicioneve të efektshme siguron mjetet për mbledhjen e këtij informacioni; asnjë strukturë administrative ndërkombëtare nuk do të ketë burimet për ta vënë problemin nën kontroll pa mbështetje të gjerë nga brenda Kosovës.

Ekzistojnë tre elemente bazë të cilat është e nevojshme të jenë pjesë e një strategjie të gjerë për krijimin e pronës:

- a) NSH-të t'i nënshtrohen ligjeve të njëjta si ndërmarrje private, veçanërisht në fushat e taksave dhe marrëdhënieve të punësimit. T'i kërkojë atyre të paguajnë faturat e shërbimeve publike, si një element kyç drejt forcimit të kufizimeve të buxhetit. Përdorimi i këtyre mekanizmave ligjore si për fillimin e procesit të mbledhjes sistematike të informacionit për NSH-të ashtu dhe për të përcaktuar se cilat NSH kanë biznes aktiv dhe në cilat prej tyre duhet të procedohet menjëherë me likuidim.
- b) Të zbatohen rregullat në ligjet e aplikueshme për dhënien me qera të pronës shoqërore. Duke reduktuar synimin e drejtuesve të NSH-ve për të vjelur të ardhurat në para të pa merituar. Kjo do të ndihmonte në shuarjen e konflikteve në lidhje me kontrollin e NSH-ve dhe do të kufizonte rezistencën ndaj privatizimit apo likuidimit eventual.
- c) Të fillojë procesin e privatizimit në një shkallë të vogël të pasurive shoqërore individuale.

#### *A. Nënshtrimi i NSH-ve ndaj ligjit*

Për momentin NSH-të janë duke operuar në limb ligjor. Regjimi i vjetër ligjor sipas të cilit është përdorur prona shoqërore nuk zbatohet më. Megjithatë shumë prej këtyre rregullave për aktivitetin tregtar të prezantuar nga UNMIK-u, të tilla si taksimi dhe marrëdhëniet e punës, nuk po aplikohen as tek NSH-të. Kjo u jep atyre një avantazh të dukshëm ndaj sektorit të ri privat gjë e cila nuk është as e justifikueshme ekonomikisht dhe thënë thjesht as e drejtë.

Koncepti i shoqërisë së drejtë është bazë për ndërtimin e një koalicioni forcash për t'i dhënë fund statusit anormal të NSH-ve. Më konkretisht kjo do të nënkuptonte fundin e privilegjeve të NSH-ve në fushat e mëposhtme.

*Taksimi:* Historikisht ka qenë nevoja e shtetit për mbledhje sa më të efektshme të të ardhurave që e udhëhoqi zhvillimin e sistemeve moderne të pronës. Anasjelltas mungesa e interesit nga ana e agjencive kosovare në të ardhurat e sektorit të NSH-ve është një nga arsyet kryesore pse UNMIK-u ka kaq pak informacion rreth kësaj. Që nga viti 1999, një nga arritjet më të rëndësishme të UNMIK-ut në ndërtimin e institucioneve ka qenë Autoriteti Qendror Fiskal (AQF-ja). Nëse rregullat e taksave aplikohen në mënyrë sistematike në këtë sektor, burimet e AQF-së do të përfshiheshin në detyrën e mbledhjes së informacionit sistematik për këto aktivitete, pasuritë dhe të ardhurat e NSH-ve – një parakusht jo vetëm për t'i sjellë ato brenda ligjit, por gjithashtu për t'i privatizuar apo likuiduar ato.

*Taksa e profitit:* Aplikimi i kësaj takse të re ndaj NSH-ve do t'u kërkojë atyre nxjerrjen e informacionit në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet dhe përgatitjen e deklaratave financiare në përputhje me standartet e kontabilitetit të AQF-së. Zbatimi i kërkesave të rregullta për nxjerrjen e informacionit të përbashkët do të ndihmonte në krijimin e një pasqyre në lidhje me aktivitetin aktual në sektorin e NSH-ve. Sigurimi i bashkëpunimit nga ana e NSH-ve do të kërkonte një njësi të përforuar të bashkëpunimit brenda administratës së taksave, e cila tashmë pjesën më tërë të personelit e ka kosovar, por që do të vazhdojë të kërkojë mbështetje të madhe ndërkombëtare.

*Taksa mbi të ardhurat ndaj punëtorëve të NSH-ve:* Kërkesa ndaj NSH-ve për të paguar tatimin mbi të ardhurat ndaj punëtorëve të tyre do të ndihmojë në sjelljen e ndryshimeve themelore në mënyrën se si janë organizuar NSH-të. Për momentin nuk ka asnjë informacion të besueshëm për përbërjen e fuqisë punëtore në shumë prej NSH-ve. Megjithatë, nga ana ligjore, NSH-të tani u nënshtrohen rregulloreve të UNMIK-ut për marrëdhëniet e punës. Ata duhet t'u sigurojnë secilit prej punëtorëve të tyre kontrata punësimi individuale dhe t'i regjistrojnë ata për qëllime të tatimit mbi të ardhurat dhe kontributet e pensionit. Zbatimi i rregullave do të kërkojë bashkëpunim ndërmjet autoriteteve të të ardhurave dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale që administron rregulloren e punës. Detyrimi i NSH-ve për të identifikuar dhe regjistruar punonjësit e tyre do të sjellë disa probleme në sipërfaqe, të cilat duhet të zgjidhen përpara se të procedohet me privatizimin.

*Tatimi mbi pronën:* Kjo taksë e re po zhvillohet përmes projekteve pilot në shtatë (nga 30) komuna dhe pritet të sigurojë 40 – 50 milion Euro në vit në të ardhmen. Kjo do të çojë drejt krijimit të financave komunale të qëndrueshme. Vjelja e tatimit mbi pronën në mënyrë sistematike, veçanërisht në pronën komerciale, do të sjellë një koalicion të natyrshëm ndërmjet komunave dhe autoriteteve të tjera të të ardhurave për të përcaktuar se çfarë prone ekziston dhe kush po e përdor atë për momentin.

*Shërbimet:* Vetëm kohët e fundit kompanitë e shërbimeve kanë filluar përpjekjet për t'i detyruar NSH-të të paguajnë faturat e tyre të shërbimeve. Ato akoma kanë një trajtim më lehtësues se sa sektori privat apo qytetarët e zakonshëm. Faturat e papaguara të shërbimeve përfaqësojnë një lloj subvencioni nga publiku i gjerë në sektorin e NSH-ve. Ato ulin nivelin e burimeve në dispozicion ndaj ofruesve të shërbimeve për të zhvilluar shërbimin e tyre dhe për të zgjeruar infrastrukturen. Ofruesit e shërbimeve publike duhet ta kenë të qartë që duhet t'ua ndërpresin shërbimet NSH-ve që nuk paguajnë. Si rezultat kjo ofron një tregues të shpejtë se cilat NSH nuk janë më në gjendje të kenë të ardhura legjitime.

Këto hapa do të ndihmojnë në përfundimin e statusit të privilegjuar të NSH-ve. Ato mund të arrihen të gjitha duke marrë rregullore të cilat janë tashmë në fuqi, por që askush nuk i ka zbatuar tek NSH-të. Duke vështirësuar kufizimet buxhetore, ata do të fillojnë nga drunjtë e kalbur te kandidatët premtues për privatizim. Në të njëjtën kohë, si një nën-produkt i pavlefshëm, ata do të vinin në lëvizje një proces sistematik për mbledhjen e informacionit në lidhje me sektorin e NSH-ve. Për të parën herë, informacioni në dispozicion të UNMIK-ut dhe institucioneve publike të Kosovës në lidhje me sektorin e NSH-ve nuk do të kufizohej më nga burimet në dispozicion të një agjencie të vetme – Departamenti i Tregëtisë dhe Industrisë ose pasardhësi i tij AKM-ja. Në fakt, një numër organesh të tjera do të kishin një interes direkt për të marrë pjesë në këtë projekt.

#### *B. Fundi i keqpërdorimit të pronës shoqërore:*

Sipas ligjit të aplikueshëm (Ligji mbi Ndërmarrjet i vitit 1988) është e paligjshme që NSH-të të japin me qera pasuritë shoqërore. Nëse ato nuk arrijnë t'i përdorin këto pasuri për qëllimin për të cilat ato janë dhënë dhe veçanërisht nëse ato abuzojnë me pronën shoqërore duke e përdorur atë për të sjellë të ardhura private të paligjshme, atyre mund t'u hiqet e drejta e përdoruesit.

Nxjerrja e pasurive individuale nga NSH-të duke hequr të drejtën e përdoruesit mund të arrihet shumë më shpejt dhe me kosto më efektive, sesa privatizimi (metoda spin-off) ose likuidimi. Sipas ligjit të aplikueshëm, komuna ka të drejtë të japë pronë shoqërore në territorin e saj. Nëse e drejta e përdoruesit është hequr, e drejta e dhënies i kalon komunës. Meqenëse komuna ka një interes të dukshëm në rivënien e kontrollit të saj mbi pronën, do të ishte një aleat i natyrshëm i AKM-së. Organi komunal i përgjegjshëm (me fjalë të tjera zyra për çështjet pronësore-ligjore) mund të hetojë rastet ku prona shoqërore në territorin e saj nuk është më në përdorim nga NSH-ja e cila mban të drejtën e përdoruesit.

Nëse shihet e udhës, AKM-së mund t'i jepet një rol mbikqyrës për t'u ruajtur nga ndërhyrjet e paautorizuara të komunave në NSH-të funksionale. Procedura p.sh. mund t'i kërkojë komunës të kërkojë miratim nga AKM-ja përpara heqjes së të drejtës së përdorimit. AKM-ja mund të përdorë autoritetin e saj si administruese e besuar e pronës shoqërore për t'u pajtuar me propozimin e komunës në emër të NSH-së. Në praktikë kjo do të thoshte që qeramarrësit ekzistues të NSH-ve të bëheshin qeramarrës të komunës. Kjo do të sillte shumë avantazhe. Çka është më e rëndësishme, do të krijonte mundësinë për kushte standarte qeraje të dhëna në rregulloret e komunës (ose AKM-së). Këto mund të përfshijnë përqindjet fikse të qerasë në varësi të zonave urbane, ndërkohë që do të drejtohen nga periudha minimale paralajmërimi dhe rregulla ligjore për mbrojtjen e investimeve në prona të bëra nga qeramarrësit. Do t'i jepte fund menjëherë praktikës abnormale të qeramarrësve privatë duke qenë të detyruar të marrin në punë punonjës jo-produktivë të NSH-ve. Këto beneficione do të çonin drejt përmirësimit të klimës për zhvillimin e biznesit privat.

Heqja e burimeve të subvencioneve të paligjshme nga NSH-të do të kishte beneficione domethënëse për AKM-në në kryerjen e detyrave të saj. Së pari, do të ndihmonte në përcaktimin e asaj se cilat NSH janë biznese thelbësore funksionale, të cilave nuk u ka mbetur asgjë përveç pasurisë së patundshme. Së dyti, duke hequr të ardhurat e paligjshme në para, do ta zbuste luftën për marrjen e kontrollit mbi NSH-të. Me heqjen e kësaj prone nga NSH-të si privatizimi ashtu edhe likuidimi kanë gjasa që të hasin shumë më pak rezistencë.

### *C. Përgatitja për privatizimin në shkallë të vogël*

Objektet individuale të biznesit që janë marrë nga NSH-të në këtë mënyrë mund të privatizohen menjëherë përmes llojit të privatizimit në shkallë të vogël, i cili është zbatuar me sukses në vende të tjera ballkanike me institucione relativisht të dobëta, duke përfshirë Bosnjën dhe Hercegovinën. Duke shqyrtuar një dekadë përpjekjesh për privatizim në ish-Bashkimin Sovjetik, ekonomisti Anders Aslund theksoi:

“Privatizimi më i lehtë në çdo vend ka përfshirë dyqanet e vogla dhe kioskat... Kur filloi procesi, ai u përfundua brenda dy viteve, pasi të gjithë e kuptuan se ishte e vetmja kohë ku ata mund të merrnin një copë pronë të lirë... Sot pak njerëz diskutojnë për privatizimin në shkallë të vogël duke nënvizuar suksesin e tij<sup>40</sup>.”

Pa marrë parasysh nëse është AKM-ja apo komuna së cilës i është ngarkuar shitja e pronave shoqërore, të ardhurat duhet të kthehen mbrapsht në bashkësinë vendase në formën e zhvillimit të infrastrukturës vendase, një masë e cila ndikon direkt në ekonominë vendase duke i dhënë hov industrisë së ndërtimit dhe ndihmon në krijimin e një ambjenti më të mirë për zhvillimin e sektorit privat. Në kontrast me privatizimin e ndërmarrjeve nën rregulloren e AKM-së, nuk do të kishte nevojë për t’i ruajtur të ardhurat e këtyre shitjeve për kreditorët e mundshëm. Sipas ligjit jugosllav, kreditorët e NSH-ve nuk ishin në gjendje të siguronin borxhet përkundrajt pronës shoqërore, apo t’i likuidonin ato në rastin e shpërbërjes së një NSH-je. T’i lejosh kreditorët të veprojnë kështu tani do të thoshte t’i japësh atyre të drejta më të forta sesa kanë pasur në kohën kur është krijuar borxhi. Sipas ligjit të aplikueshëm, kur një NSH pushon së ekzistuari apo e drejta e përdoruesit është hequr, prona thjesht i kalon komunës. Megjithatë nuk ekziston asnjë kufizim ligjor për AQF-në për të taksuar të ardhurat e privatizimit në shkallë të vogël dhe për t’i përdorur disa prej këtyre të ardhurave p.sh. për të financuar ri-trajnimin apo asistencën sociale për punëtorët e tanishëm ose të larguar.

Nga një strategji e tillë ka të mira të dukshme ekonomike, të cilat do ta shpërndanin pronën e patundshme gjerësisht dhe do t’i sillnin përfitime direkte sektorit të ri privat nëpërmjet reduktimit të pasigurisë në lidhje me titullin e pronës. Gjithashtu ekzistojnë përfitime të dukshme politike për UNMIK-un dhe AKM-në. Privatizimi në shkallë të vogël do të ishte elementi i parë i strategjisë së gjerë të privatizimit për të ofruar të mira publike konkrete. Gjithashtu do të fuqizonte planin e veprimit të UNMIK-ut për sa i përket shtetit ligjor. Me vënien e pronës në duar private, do të bëhet i mundur dallimi mes mbledhësve të ligjshëm të qerasë dhe mashtruesve.

### *D. Koalicioni për reformën e pronës*

Zhvillimi i politikës duhet të fokusohet jo vetëm tek rezultatet, por gjithashtu edhe në kufizimet e ndikimit ndërkombëtar dhe vështirësitë reale të zbatimit. Në mënyrë të paevitueshme, progresi në fushën e reformës së pronës do të përmbajë një shkallë përpjekjesh dhe gabimesh – një proces të mësuari i cili bëhet i besueshëm vetëm përderisa të nxirren mësimet e duhura. Mësimi më i rëndësishëm nga tre vitet e kaluara ka të bëjë me nevojën për të investuar menjëherë në mbledhjen e informacionit nga terreni, në analizë dhe administrim të njohurive. Kjo përfshin njohuritë rreth gjendjes së sektorit të ndërmarrjeve shoqërore, rreth

<sup>40</sup> Anders Aslund, *Në ndërtim të kapitalizmit: transformimi i ish-blokut sovjetik*, Cambridge University Press, 2002, fq. 167-8.

realitetit se si prona komerciale është administruar dhe përdorur në të gjithë Kosovën, si dhe ndikimi i iniciativave konkrete ndërkombëtare. Kjo përfshin njohjen e atyre aktorëve në sektorin e ri privat dhe në institucionet kosovare të cilat përfitojnë nga prezantimi i një sistemi të drejtë dhe transparent, në mënyrë që ata të tërhiqen drejt një koalicioni efektiv reformimi. Kjo përfshin gjithashtu një kuptim më të mirë të kapaciteteve të administratave të komunave në të gjithë Kosovën. Institucionet që kërkojnë qera kudo janë të interesuar që për ta të ketë informacion të shpërndarë, të paqartë dhe të paplotë rreth aktiviteteve të tyre. Nga ana tjetër, mjeti thelbësor bazë i aparatit të shtetit modern është kapaciteti për të mbledhur informacione të sakta rreth aktorëve ekonomikë e cila, nga ana tjetër, lejon mbledhjen efektive të të ardhurave. Siç ka shkruar një ish-drejtor ekzekutiv i Bankës Botërore, institucionet ekonomike inefficente janë më shpesh fenomen normal, sesa përjashtim. Nuk ka “asnjë proces përzgjedhjeje evolucionar që çon drejt institucioneve efikente, duke lënë jashtë ato jo-efikente. Në shumicën e rasteve është e kundërta.”<sup>41</sup>

Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm për të drejtat e pronës në Kosovë për pasojë do të kërkojë një aleancë të gjerë dhe të strukturuar mirë të institucioneve, duke përfshirë Autoritetin Qendror Fiskal (AQF), Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, po ashtu edhe organeve komunale, agjencive kadastrale dhe organizatave të tjera që sigurojnë mbështetje teknike ndërkombëtare në këtë fushë. Shkëmbimi i informacionit mes këtyre aktorëve nuk duhet t’i lihet rastësisë, por duhet të jetë në thelb të çdo strategjie të reformës së pronës. Duke pasur parasysh masën e sfidës, marrja seriozisht e reformës së pronës do të kërkojë që ajo të bëhet pjesa qendrore e përpjekjeve të UNMIK-ut në Kosovë – po ashtu siç u bë edhe fushata me bazë të gjerë për rikthimin e shtetit ligjor në fushën e pronës rezidenciale, operacioni më intensiv i misionit ndërkombëtar në Bosnjë dhe Hercegovinë. Në Bosnje burimet dhe ekspertiza e aktorëve të ndryshëm institucionalë janë shfrytëzuar së bashku përmes krijimit të një ndër-agjencie në kuadër të Dërgatës së Kthimit dhe Rindërtimit (RRTF) dhe një plan të elaboruar për zbatimin e së drejtës pronësore. UNMIK-u mund të konsiderojë gjithashtu krijimin e një mekanizmi për koordinimin mes shtyllave – ‘dërgata për krijimin e pronës’ – e cila do të bashkonte aktorët kyç ndërkombëtarë dhe kosovarë e po ashtu edhe donatorët ndërkombëtarë. Kjo do të ndihmonte në përfshirjen e shumë detyrave të ndryshme (legjislative, rregullatore, fiskale, zhvillimin institucional) brenda një fushate të përgjithshme.

Megjithatë, është e rëndësishme të nënvizohet që sfida nuk është thjesht një kthim në *status quo* të paraluftës, siç ishte në Bosnjë. Përkundrazi, kjo kërkon krijimin e një regjimi ligjor dhe institucional që zëvendëson eksperimentin ligjor socialist, rënia e të cilit ka çuar në situatën anarkike të përshkruar në këtë raport. Fushata e UNMIK-ut për krijimin e pronës do të kërkojë gjithashtu një rishqyrtim të prioriteteve ndërkombëtare në ndarjen e burimeve për asistencë teknike dhe ndërtim të institucioneve. Një numër institucionesh – nga administrata e taksave në Autoritetin Qendror Fiskal të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale – do të kishte nevojë për burime njerëzore shtesë për aq sa do të zgjasë fushata. Agjencitë me prani në terren në të gjithë Kosovën do të luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm, ashtu si në Bosnjë në kuadër të RRTF-së, në mbledhjen e informacioneve thelbësore dhe në zbatimin e politikës monitoruese.

---

<sup>41</sup> Eduardo Wiesner, ish-drejtor ekzekutiv i Bankës Botërore. *Ekonomia e kostos së transaksioneve dhe kërkimit të qerave publike në vendet në zhvillim: drejt një teorie të dështimit qeveritar*. Në: Robert Picciotto dhe Eduardo Wiesner, VII., *Vlerësimi dhe zhvillimi – dimensionin institucional*, Botuesit e Transaksioneve 1988 fq. 117.



Çka është më e rëndësishme, krijimi i pronës do të thotë komunikim. Duhet një fushatë politike e sofistikuar për të bindur njësitë e gjera të shoqërisë kosovare për të mirat e një politike të tillë. Një nga mësimet më të rëndësishme të tre viteve të kaluara të përpjekjeve ndërkombëtare është që politikat ambicioze të formuluar brenda UNMIK-ut duhet të komunikohen në mënyrë të efektshme në mënyrë që të ndërtohet një koalicion i gjerë interesash, nëse duan që të ndryshojnë sjelljen e aktorëve të vërtetë ekonomikë në këtë fushë. Përfundimisht, janë njerëzit e Kosovës ata të cilët duhet të binden për meritat e një regjimi të drejtë, të efektshëm dhe universal të pronës nëse duan që ekonomia dhe shoqëria e tyre të përparojë përtej fazës së asistencës masive ndërkombëtare.